E hënë, 18 tetor 2021

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.31 paradite

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëmëgjes dhe mirë se keni ardhur të gjithëve.

Sekretare, të lutem, thirr çështjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Si zakonisht, ju lutem palëve të prezantohen, duke filluar nga Prokuroria.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëmëngjes. Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar të pranishëm këtu janë Alex Whiting, Zëvendësprokuror i Specializuar; James Pace, Prokuror [i] Asociuar; dhe z. Mat Halling, gjithashtu Ndihmësprokuror; Line Pedersen, Përgjegjëse e Çështjeve dhe e Dëshmive, Provave. Dhe unë jam Valeria Bolici, Prokurore në ZPS.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Tani Mbrojtja. Z. Rees.

Z. REES: [Përkthim] Unë jam Jonson [sipas përkthimit] Rees QC [fonetikisht]. Përfaqësoj z. Gucati. Jam këtu bashkë me Huw Bowden, bashkëavokat dhe Muharrem Halilaj, Faye Wignore

dhe Joseph Bawden.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman. Faleminderit.

Z. CADMAN: [Përkthim] Jam këtu bashkë me Carl Buckley, Znj. Miriam. Dhe z. Haradinaj është i pranishëm. Faleminderit, znj. Poppy Henderson, Omar Salivan.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Tani vë re se të gjithë janë të pranishëm.

Z. ROCHE: [Përkthim] Unë jam Ralph Roche nga departamenti i Zyrës Administrative, shërbime gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Sot fillojmë seancën duke dëgjuar dëshminë e Prokurorisë. Gjatë dy javëve, presim të dëgjojmë dëshminë e të paktën dy dëshmitarëve. Do të punojmë nga e hëna deri në të enjte këtë javë dhe javën tjetër. Dhe të premten vetëm nëse është rreptësishtë e nevojshme. Çdo ndryshim në këtë program do t'i i bëhet i njohur palëve.

Përpara sesa të fillojmë, do të trajtojmë disa çështje.

Në 12 tetor 2021, Mbrojtja e z. Nasim Haradinaj parashtroj një kërkesë për leje për të apeluar vendimin e Trupit Gjykues lidhur me pranueshmërinë e provave. Paneli nuk e pranoi kërkesën në një vendim të nxjerrë në 15 tetor 2021 dhe do të vazhdojë të dëgjojë dëshminë, duke vënë në dukje se, në qoftë se dhe kur këto deklarata [të] dëshmitarëve në fjalë

të ofrohen nga Prokuroria, Mbrojtja do të ketë mundësi të plota për të kundërshtuar pranimin e tyre dhe do të paraqesë argumente që mendon se kanë rëndësi, Mbrojtja, gjithashtu, do të ketë mundësi të bëjë pyetjet këtyre dëshmitarëve lidhur me çështjet që do të diskutohen dhe të lidhura me pranimin e deklaratave të tyre.

Këtu përfundon njoftimi për lejen e Haradinajt për të apeluar.

Gjithashtu, Trupi Gjykues informacion palët se e lëmë për më vonë çdo mendim lidhur me rëndësinë materiale dhe nxjerrjen e dokumenteve sipas rregullit 102(3)për aq sa pyetja e dëshmitarëve 4841 dhe 4842 mund të ketë lidhje me ecurinë e çështjes që do të ndjekë Paneli në këtë çështje.

Kjo do të thotë se vendimi i konsoliduar për F307, 316, 361 dhe çdo parashtrim i mëtejshëm, përfshirë përgjigjet dhe kundër përgjigjet, do të nxirret posa që të jetë mundësisht -- të ishte e mundur gjatë -- pas dëshmisë së këtyre dy dëshmitarëve.

Paneli, gjithashtu, vë në dukje se rëndësia materiale dhe nxjerrja e dokumenteve sipas rregullit 102(3) lidhet ngushtë me pretendimet për nxitje të ngritura nga Mbrojtja për shtyrje.

Ndërsa provat që lidhen me këtë çështje do të ofrojnë gjatë gjyqit, Paneli, Trupi Gjykues sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut do t’i konsideroj

këto pretendime me idenë për të përcaktuar nëse pretendimi është, si mbas gjuhës së Gjykatës Evropiane, plotësisht i pamundur dhe, në qoftë se është i tillë, në qoftë se ZPS-ja e ka përmbushur detyrën e saj në lidhje me këtë çështje.

Për këtë arsye, Trupi Gjykues mendon se një vendim i ardhshëm për dokumentet sipas rregullit 102(3) do të mund të ndikohen nga prova, dëshmia e dëshmitarëve në qoftë se ata janë në gjendje të japin dëshminë në lidhje me këtë çështje. Në qoftë se ndonjë nga palët është -- shqetësohet lidhur me materialet sipas kërkesës, sipas rregullit 102(3) do t'i nënshtrohen një urdhri të mëtejshëm, Mbrojtja mund të kërkojë që asnjë nga këto dëshmitarë -- që secili prej këtyre dëshmitarëve të thirret për pyetje të mëtejshme në të ardhmen.

Gjithashtu, Trupi Gjykues, i njofton palët se vendimi për mocionin e ZPS-së për të hequr dëshmitarë të Mbrojtjes F312, do të jepet pasi Mbrojtja -- pasi të bëhen përgatitjet për diskutimin e çështjes.

Këtu përfundon diskutimi për rregullin F312.

Kur u takuam herën e fundit, kur u hap kjo çështje, Z. Gucati donte të bënte një deklaratë dhe unë i thashë se këtë mundësi do ta kishte më vonë. Unë e pashë që ne e përfunduam seancën dhe z. Gucati nuk pati mundësi të fliste.

Sipas rregullit 142(1), paragrafi 1, i pandehuri mund të bëj një deklaratë në këtë çështje. Prandaj, Paneli e fton të akuzuarin të bëjë një deklaratë të tillë, me kusht që ato të

lidhet me çështjet dhe të mos kalojnë dy-tre minuta.

Në qoftë se i akuzuari nuk dëshiron ta bëj këtë gjë mund të jap një rast tjetër.

Z. Gucati, dëshironi të bëni një deklaratë pa betim në këtë moment?

I AKUZUARI GUCATI: Nëse ka mundësi një seancë tjetër, i nderuar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do ta japim këtë mundësi kur të vijë ai moment.

I AKUZUARI GUCATI: Faleminderit shumë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman, je i ngritur.

Z. CADMAN: [Përkthim] Përpara se ta pyesni z. Haradinaj, unë do ta vlerësoja që të merrja udhëzime nga z. Haradinaj për këtë çështje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në qoftë se kërkon një minutë, mjafton, mund ta bëni tani.

[Përfaqësuesit e Mbrojtjes dhe i akuzuari këshillohen midis tyre]

Z. CADMAN: [Përkthim] Jam mirënjohës. Z. Haradinaj në këtë moment nuk dëshiron të bëj ndonjë deklaratë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Haradinaj. Dhe siç i thashë z. Gucati, edhe ju do t'ju jepet një rast tjetër në një kohë tjetër.

Z. Rees, mos doni të bënit një parashtrim me gojë lidhur

me disa informacione të parashtruar dje.

Z. REES: [Përkthim] Dua ta bëj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëhere, mund ta bëni tani.

Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës ju jeni në dijeni se gjatë javës që shkoi Prokuroria mbajti seanca për përgatitjen e dëshmitarëve si me dëshmitarin që do të fillojë sot të dëshmojë, por edhe me dëshmitarin e dytë që është parashikuar të japë dëshmi gjatë kësaj periudhe dy javore.

Sigurisht, palët janë në dijeni për këtë sepse Prokuroria dërgoi një email Trupit Gjykues dhe Mbrojtjes, duke përcaktuar në lidhje p.sh., me 04841 disa sqarime të vogla, ndryshime apo korrigjime në deklaratën e tij. Gjithashtu, në lidhje me dëshmitarin e dytë 04842, në një email, ata konfirmuan se nuk do të kishte asnjë sqarim, ndryshim apo korrigjim në deklaratën e tij por se ai ka paraqitur informacion të ri dhe ishte futur tre paragrafë materiali i cili nuk është adresuar në asnjë prej deklaratave të tij.

Dua të them se si punonjës i stafit këtu, ky informacion nuk ka qenë i ri për të.

Pas këtyre dy emaileve, Prokuroria kërkoi leje për të lejuar 04841 të mbështetej -- të përdorte disa shënime, implikimet janë që ato janë shënime të përgatitura prej saj gjatë përgatitjes dhe finalizimit, pra, përfundimit të deklaratës.

Dhe Mbrojtja vuri në dukje, se ne nuk do të kishim kundërshtim për nxjerrjen e këtyre shënimeve. Dhe kjo u konfirmua dhe nga ju, si Trup Gjykues. Dhe të premten në mëngjes, Mbrojtjes ju tha se dhe Trupi Gjykues kishte qasje, në një dokument i cili, nuk ishin shënime të përgatitura gjatë përgatitjes. Në fakt, ju dha një projekt, një draft i ndryshëm formal zyrtar i ndryshuar, pra, të deklaratave të dëshmitares.

Po t'i shikosh këto shënime, bashkë me përmbledhjen e dëshmisë së dëshmitares që na është dhënë dhe listën e provave materiale që Prokuroria do të përdorë me këtë dëshmitar në pyetjet e veta dhe përmbajtjen e kërkesës, sipas rregullit 154 që është bërë në lidhje me dëshmitarin 04841, duket e qartë se ata përpiqen të marrin prej saj dëshmi që nuk është trajtuar në një kuptim të njëmend në deklaratat e saj.

Ne e ngremë këtë çështje, në këtë moment, sepse jemi të shqetësuar se Prokuroria po përpiqet t'i bëjë bisht detyrimeve të saj të qarta për nxjerrje që janë sipas ligjit dhe rregullores, duke përdorur, në fakt, deklarata informale të ndryshuara që i referohen shënimeve, përmbledhje të dëshmitarit të cilat i shtojnë fushëveprimin dëshmisë së dëshmitares, të gjitha këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe sipas nenit 21(6) të ligjit dhe rregullit 102, ne parashtrojmë shumë qartë se këto janë të qarta. Pra, neni i ligjit, rregulli 102 e Rregullores, e bën [të] qartë se Prokuroria duhet të njoftojë në kohën e duhur provat që ato

duan -- kërkojnë të marrin nëpërmjet deklaratave të dëshmitarëve.

Rregulli 102(1)(b) ofron një kohë të përcaktuar nga Trupi Gjykues, që është jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes së provave të Prokurorisë, pra, deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që Prokuroria synon t'i thërrasë këtu, raportet e ekspertëve, depozitimet e të gjitha, pra, dokumentet që do të përdorë.

Rregulli 102, parashikon që çdo deklaratë që nuk është nxjerrë në kohën e duhur në bazë të të cilit ajo, Prokuroria, kërkon të thërras dëshmitarë në gjyq, duhet t'i bëhet e njohur Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundur shoqëruar nga arsyet për nxjerrjen e saj me vonesë. Pra, sipas nënrregullit 4, ata duhet t'i nxjerrin ato në fazën -- deri në fund të fazës së paragjyqësore.

Prandaj, Prokurori i Specializuar, në këtë rast Prokuroria, duhet të përdorë rregullin apo rrugën joformale dhe t'i bëjë bisht këtyre dispozitave. Në qoftë se Prokuroria do të marrë dëshmi nga Dëshmitari 04841 kjo e tejkalon fushëveprimin e deklaratave të saj. Duhet të paraqesin deklarata të reja, të cilat duhet t'i bëhen të ditura Mbrojtjes dhe duhen shoqëruar me arsye se pse nxirren me vonesë me një kërkesë që duhet të jetë bërë Gjykatës për leje që ta shtojë atë provë në listën e provave.

Në këtë fazë, ne parashtrojmë se kjo gjë nuk është bërë.

Nuk është bërë në lidhje me Dëshmitarin 04841 dhe me Dëshmitarin 0841482 [sipas përkthimit].

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptoj kundërshtimin tuaj, a mund të më thoni se çfarë kërkoni?

Z. REES: [Përkthim] Ne kërkuam konfirmim javës që shkoi, se nuk donim të shqetësonim Trupin Gjykues, që të mos nxitoheshim, pra. Kërkuam konfirmim nga ZPS-ja, nga Prokuroria që ata të përmbaheshim vetëm përmbajtjes së deklaratave. Ata u përgjigjën në një mënyrë të tillë që tregoi se nuk do ta bënin këtë.

Në këtë rast, ata duhet të paraqesin deklarata të reja të këtyre dy dëshmitarëve. Nëse do t'i përdorin ato, duhet t'i paraqesin zyrtarisht, bashkë me arsyen se pse po e bëjnë këtë me vonesë dhe duhet t'i bëjmë kërkesë Gjykatës që t'i japë leje që këtë provë t'ia shtojnë listës së provave.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë informacion të ri që ata po kërkojnë të paraqesin që ju nuk e dini? Pra, ka ndonjë gjë të re që nuk është paraqit, përfshirë aty?

Z. REES: [Përkthim] Po. P.sh., po të shikojmë ato që quhen si shënime, në fakt, është një draft deklaratë e re e Dëshmitares 04841, po ta shikoni këtë dokument, të nderuar Gjykatës, keni për të parë informacion të ri në paragrafin 4 të 29 gushtit 2000; paragrafi 10, shumë informata të reja.

Ne kemi kërkuar nxjerrjen e materialit p.sh., të emrave

që Prokuroria thotë -- përmbajnë ato paketat e dokumenteve dhe pasdite të premten neve na i dhanë këto paragrafë që quhen si shënime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pyetja ime është e thjeshtë. Çfarë kërkoni? Çfarë doni që të bëjë Prokuroria?

Z. REES: [Përkthim] Deklaratë të re, me arsyet për vonesën e nxjerrjes dhe me lejen e Trupit Gjykues që Prokuroria ta përdori atë dëshmi, përmbajtjen e saj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dëshironi t’i përgjigjeni?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Qëndrimi i Prokurorisë është se parashtrimet e Mbrojtjes janë plotësisht të pabazuara, jo në kohën e duhur dhe të papjekura.

Nuk janë të -- ato nuk bazohen në kornizën ligjore, e cila parashikon që deklaratat, në këtë rast, të cilat ka bërë dëshmitari që t’i bëhen të njohura palës kundërshtare, gjë që ne e kemi bërë në këtë rast.

Rregulli nuk thotë apo nuk nënkupton asnjë mënyrë që informacioni që kërkohet të merret nga dëshmitari duhet t’i përmbahet vetëm informacionit specifik që ka diskutuar dëshmitari në deklaratat e mëparshme.

Neni 143 i Rregullores parashikon se pala mund t’i pyetje dëshmitarit, jo të kufizuara vetëm për ato -- tek ato çështje që ka trajtuar dëshmitari në deklaratat e mëparshme. Aty

thuhet gjithashtu, se një palë mund t'i tregojë dëshmitarit çdo provë në përputhje me rregullin, rregullat apo rregulloren dhe jo vetëm ato që ka diskutuar dëshmitari në kuadër të deklaratave të mëparshme.

Informacioni që ZPS-ja synon të nxjerrë nga dëshmitarët e saj i është bërë i njohur Mbrojtjes në bazë të përmbledhjeve të rregullit 95 që në prill të 2020-s, të cilat janë riprodhuar me ndryshime të vogla lidhur me numrin ERN me informacionin që është bërë i njohur me një parashtrim të 1 tetorit 2021. Njoftimi i mëtejshëm i është dhënë nëpërmjet listës së provave që ZPS-ja synon të adresojë me dëshmitarin.

Në këtë drejtim, dëshiroj të vë në dukje se në vendimin e ZPS-së për mocionin, për tabelën, parashtrimi F0034, paragrafi 39 dhe 56, Trupi Gjykues vuri në dukje se Prokuroria do të ketë mundësi të marri dëshmi nëpërmjet dëshmitarëve që do të thërrasë. Jo të gjitha këto prova materiale nuk janë adresuar -- janë adresuar në dëshmitë e mëparshme, megjithatë, ZPS-ja kërkon mundësinë, siç parashikohet në kuadrin ligjor, të marrë dëshmi nga dëshmitarët, të lidhura me provat në listën e provave sipas njohurive që kanë dëshmitarët.

Dua të theksoj gjithashtu se kundërshtimi i Mbrojtjes është i parakohshëm, sepse njoftimi ka qenë -- i është bërë që në prill 2020 për këtë gjë dhe deklarata e fundit, që është një version i ndryshuar i të mëparshmit, i është bërë e njohur në 7 maj 2021.

Kanë kaluar që nga ajo kohë disa muaj dhe objekti i dëshmisë që do të jepet prej këtyre dëshmitarëve përpara Trupit Gjykues i është bërë -- ka qenë i njohur për Mbrojtjen për muaj të tërë.

Nga një pikëpamje tjetër, Mbrojtja, kundërshtimi i Mbrojtjes është i papjekur lidhur me pyetjet që ne do të duam t'i bëjmë dëshmitarit të cilat nuk i kemi bërë akoma. Dhe kështu që çdo kundërshtim lidhur me mungesën e njohurive për çështjet që do të dëshmojnë dëshmitarët nuk mund të kundërshtohet, ata mund t'i bëjnë pyetje, mund ta kundërshtojnë përmes pyetjeve që do t'i bëjnë dëshmitarëve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Rregullat 95(4)(b) dhe 102 rregullojnë njoftimin që Mbrojtja ka të drejtë të marrë nga ZPS-ja.

Në këtë kuptim, Mbrojtjet e dëshmive të propozuara dhe shtojcat e shumta janë parashtruar. Njoftimi është bërë. Në qoftë se ZPS-ja kërkon të marrë dëshmi nga këto dy dëshmitarë lidhur me të cilat Mbrojtja thotë s'ka pasur njoftim të duhur dhe kjo krijon vështirësi apo padrejtësi, atëherë Mbrojtja mund të kërkojë mjet ndreqës të duhur nga Trupi Gjykues në kohën që paraqitet prova.

Ju mund të kërkoni shtesë. Mund të kërkoni për t'u përgatitur për të bërë pyetje. Mund të kërkoni t'i thërrisni dhe njëherë dëshmitarët, në qoftë se është e nevojshme gjatë pyetjeve që do t'i bëni.

Ne kërkojmë që Mbrojtja të kërkojë secilin prej këtyre mjeteve ndreqëse në qoftë se e gjykon të nevojshme kur mendon se nuk ka pasur -- kur pretendon se nuk ka pasur njoftim dhe Trupi Gjykues do të japi vendim për këto kërkesa.

Në rregull. Tani jemi gati të fillojmë marrjen e provave në këtë gjyq.

Dëshmitar, të lutem.

Sill dëshmitarin e parë, Sekretare.

Z. REES: [Përkthim] Vazhdojmë të kemi kundërshtim lidhur me kërkesën e rregullit 154. Ne e ngritëm këtë. Do ta ngremë tani apo kur të vij dëshmitari?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta sjellim dëshmitarin, do të dëgjojmë deklaratën e saj dhe pastaj do t'ju jap leje.

[Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, znj. Pumper. Sekretarja do t'ju japi tekstin e deklaratës solemne që duhet të bëni sipas rregullit 141(2) të Rregullores.

Vazhdoni ju lutem.

DËSHMITARJA: [Përkthim] E ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës dhe se nuk do të mbaj asnjë gjë që unë di.

DËSHMITARJA: Zdenka Pumper

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Uluni, znj. Pumper, mund të uleni.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj. Pumper, kemi një diskutim paraprak, që do të bëhet në këtë moment, prandaj duroni pak deri sa ta zhvillojmë.

Z. Rees, keni fjalën. Shkurtimisht. E di besoj se cila do të jetë pyetja juaj.

Z. REES: [Përkthim] Në 14 tetor, Prokuroria bëri një parashtrim për pranimin e deklaratave të dëshmitares, sipas rregullit 105(4), bashkë me një listë provash të cilat përmenden në të. Gjithashtu, kanë parashtruar një listë më të gjatë provash materiale të cilat ZPS-ja dëshiron t'i trajtojë përmes kësaj dëshmitareje.

Në 17 shtator, ne kishim bërë një mocion për të kundërshtuar pranimin e provës që i referohej përmbajtjes së deklaratës së cilën Prokuroria kërkon ta paraqesë përmes rregullit 154 dhe çështje më të gjera që lidhen me disa nga provat materiale të cilat jepen në listën e provave materiale që Prokuroria kërkon të trajtojë përmes kësaj dëshmitareje.

Në veçanti dokumentet 134, 135, 174, 175, 177 dhe 178, dhe 325 të asaj liste.

Besoj që Prokuroria do të vazhdojë me këtë kërkesë për të paraqitur deklaratat në bazë të rregullit 154? Në qoftë se do

ta bëjë, unë e kundërshtoj.

Deklaratat janë, në fakt, raporte të hetimeve të Prokurorisë, ku ajo, Prokurorja, ajo ka -- është përmbledhur dhe ka shprehur konkluzione, pra, përfundime të nxjerra nga dokumentet të cilat nuk janë bërë të njohura Mbrojtjes dhe ZPS-ja do t'i paraqesë ato si prova për t'i shqyrtuar vetë Trupi Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptoj kundërshtimin tuaj. Kemi nevojë për të tjera?

Z. REES: [Përkthim] Kjo paraqitet në mocionin për të kundërshtuar pranueshmërinë e provave që ne kemi paraqitur me numrin -- që është parashtrimi F00317.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptojmë plotësisht kundërshtimin tuaj. Por, ne nuk i pranojmë deklaratat deri në momentin kur juve, domethënë, të ketë mbaruar marrja në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pastaj ju të keni bërë pyetjet tuaja për dëshmitaren. Pastaj do të vlerësojmë situatën.

Z. REES: [Përkthim] A e kuptoj unë saktë, që ju po thoni që do t'i lejoni Prokurorisë që të përdorë qasjen e saj dhe pastaj do të vendosni për pranueshmërinë e tyre pasi të bëhen pyetje për dëshmitarët?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po. Kjo është përgjigja.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

Prokurore, do ta merrni ju këtë dëshmitaren?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Sa për informacion, më lejoni të them që sërish synojmë që të kalojmë formalitet e rregullit 154, neni 8 dhe të artikulojmë kërkesën tonë përpara Trupit Gjykues. Më lejoni të them, gjithashtu, që provat materiale të cilat janë dhënë në parashtrimet e protokolluara të Prokurorisë sesa i takon këtij dëshmitari janë printuar po ashtu. Ndërkohë, që edhe dosjet i janë treguar Zyrës së Administrimit dhe me lejen e Trupit Gjykues, do të kërkoja që të këto kopje të printuara të dokumenteve të mund t'i vihen në dispozicion dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Harrova që të jepja disa udhëzime për dëshmitaren. Nuk e di në qoftë se mund të ndalonim një moment.

Znj. Pumper, ju kërkoj ndjesë.

Znj. Pumper, neve do të fillojmë dëshminë tuaj sot, e cila do të zgjasë për disa ditë. Siç e dini, Prokuroria do t'ju bëj së pari pyetje ju. Dhe pasi të ketë përfunduar prokuroria Mbrojtja do t'ju bëj pyetje. Ndërkohë edhe anëtarë të Trupit Gjykues mund të kenë disa ditë -- mund të kenë disa pyetje për ju.

Vlerësimi i Mbrojtjes sa i takon kohëzgjatjes është 5 ditë dhe ne shpresojmë që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve të cilat kanë palët. Gjithashtu, Trupi Gjykues, mund të lejojë edhe disa pyetje të tjera pas raundit të parë të pyetjeve.

Megjithatë, ju lutem, në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, ndijuni të lirë që t’i kërkoni palëve që të formulojnë pyetjen ose thoni që nuk e kuptoni pyetjen në mënyrë që të sqarohet pyetja që ju drejtohet.

Po ashtu, ju lutem, mundohuni që të jepnin bazën e njohurive, fakteve dhe rrethanave për të cilat ju do të pyeteni.

Trupi Gjykues e kupton që juve do të pyeteni nga ZPS-ja për të dhënë dëshminë lidhur me disa korrigjime të bëra në deklaratat tuaja. Dhe kur të ndodhë kjo gjë, ju kujtohuni që të konfirmoheni që proces -- që deklarata juaj, le të themi, të korrigjohet dhe të jepet e lista e korrigjimeve si  dhe të reflektohen me saktësi ato në deklaratën tuaj.

Ju lutem, flisni përpara mikrofonit, prisni pesë sekonda përpara se t’i përgjigjeni pyetjes në mënyrë që t’ju ndjekin përkthyesit.

Gjatë ditëve pasuese që do të jepni dëshminë këtu përpara Gjykatës, nuk lejoheni që të flisni me askënd lidhur me përmbajtjen e dëshmisë tuaj. Në qoftë se dikush jashtë Gjykate ju kërkon që të japi një informacion rreth dëshmisë tuaj, ju lutem na e bëni me dije këtë gjë.

Znj. Bolici, fjala për ju.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]  Faleminderit.

Tani do të doja që të kërkoja leje nga Trupi Gjykues që t'i japim një version të printuar të provave materiale të

cilat janë njoftuar përmes sistemit juridik *Legal Workflow.*

Pyetje nga znj. Bolici:

PY. Ju lutem, a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin për procesverbal?
PË. Unë quhem Zdenka Pumper.
PY. Cila është ditëlindja juaj?
PË. 19 maj 1972.
PY. Hetuese, a mund t'i tregoni Gjykatës se ku punoni aktualisht?
PË. Unë punoj për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
PY. Dhe sa kohë keni që punoni me ZPS-në?
PË. Unë jam bërë pjesë e SITF-së në janar 2016 dhe më pas në verë u bëra pjesë e ZPS-së.
PY. Cili është titulli juaj profesional i profesionit tuaj?
PË. Titulli im është hetuese, por ndërkohë brendapërbrenda unë jam koordinatorja e hetimit.
PY. Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tuaja?
PË. Detyrat e mia janë, ndërmjet shumë gjërave të tjera, që të intervistoj dëshmitarë, të përgatis planet e punës për Prokurorinë. Të analizoj provat dhe të shkruaj raporte, të analizoj provat, të përgatis planet e punës. Këto janë pak a shumë detyrat e mia.
PY. A mund të na thoni, ju lutem, shkurtimisht, se cila është përvoja juaj profesionale?
PË. Unë kam qenë oficere policie me policinë austriake deri

në vitin 2008, mendoj. Pra, nga viti 1999 deri më sot unë kam punuar për organizatat ndërkombëtare, gjithmonë në rolin e hetueses. Kam punuar për misione të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, por kam punuar gjithashtu edhe për institucione të Bashkimit Evropian.

PY. Faleminderit. A keni kryer ndonjë detyrë juve lidhur me çështjen kundër Hysni Gucatit dhe Z. Haradinaj?

PË. Po. Unë jam -- kam qenë e përfshirë në një punë goxha të konsiderueshme pune në lidhje me këtë çështje.

PY. Ju lutem, a mund të na thoni shkurtimisht se cilat janë pjesët kryesore që keni mbuluar lidhur me këtë çështje?

PË. Unë kam koordinuar kontrollin, kërkimin që ka ndodhur në OVL e UÇK-së dhe kam koordinuar kërkimin, pra, kam përpunuar gjithashtu dhe një pjesë të mirë të provave. Kam raportuar kontrollin e kryer dhe kam rishikuar një pjesë të konsiderueshme të materialit. Në veçanti, ato materiale të cilat janë sekuestruar nga Organizata e Veteranëve të Luftës, të cilët përmenden në paketën 1, 2 dhe 3, si dhe materialin i cili na është dërguar, na është dorëzuar neve nga organi mediatik.

PY. A mund të na thuash, a mund të na shpjegosh, ju lutem, se çfarë nënkuptoni me shkurtimin "Paketa 1"?

PË. Në deklaratat e mia, unë i jam referuar paketave të ndryshme të informacionit të cilat janë sekuestruar nga OVL-ja e UÇK-së. Dhe "Paketa 1" është paketa është sekuestruar më

datë 7 shtator. Dhe në datën 8, Paketa 4 na u dha neve nga media, nga organi mediatik dhe kjo u pasua nga sekuestrimi i dytë dhe kam përshtypjen që bëhet fjalë për datën 17 dhe në fakt, Paketa 2 u ndoq nga sekuestrimi i paketës së fundit, i Paketës 3, i cili u realizua më datë 22.

PY. Faleminderit. A keni analizuar, a keni shikuar artikuj mediatik ose artikuj të ndryshëm të cilët janë marrë nga burimet publike për këtë -- të cilat lidhen me këtë çështje?

PË. Po, kam analizuar.

PY. Faleminderit. A keni përgatitur deklarata me shkrim apo raporte, njoftime zyrtare lidhur me detyrat të cilat ju keni kryer në çështjen kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt?

PË. Po.

PY. Faleminderit. Dhe a i keni parashtruar këto deklarata, raporte dhe shënime zyrtare si prova materiale?

PË. Po, i kam parashtruar.

PY. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dua që të kërkoj ndihmën e sekretarit të seancës gjyqësore për të treguar provën materiale me numrin e identifikimit ERN 084015 deri në 085026, që është deklarata e këtij dëshmitari që mban datën 29 tetor 2020.

PY. Hetuese, ju keni versionin e printuar në nënndarjen 1 të dosjes, së fashikullit që ju është dhënë përpara.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për procesverbal, duket sikur i

thashë gabim numrat e fundit. Pra, bëhet fjalë për dokumentin me numër identifikimi 084015 deri në 084026.

PY. A e keni të identifikuar dokumentin tek dosja që keni përpara.

PË. Vetëm një moment, ju lutem. Po e gjeta.

PY. Ju lutem, a mund t'i hidhni një sy dokumentit që keni përpara.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar, kërkoj udhëzime, domethënë, po presim që Sekretarja të na e shfaqë dokumentin që sapo citova në ekran.

PY. A mund ta shikoni dokumentin në ekran, hetuese?

PË. Po, e shoh.

PY. A e njihni këtë dokument që sapo ju treguam?

PË. Po, e njoh.

PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues, se kush është autori i këtij dokumenti?

PË. Unë e kam shkruar këtë dokument.

PY. Ju lutem, a mund të shihni faqen 12 të këtij dokumenti që është dokumenti me ERN 084026. A është ky nënshkrimi juaj?

PË. Po, është nënshkrimi im.

PY. A ju është dhënë mundësia që ta rishikoni këtë deklaratë përpara këtij -- kësaj dëshmie dhe të thoni korrigjime ose modifikime të vogla në qoftë se ishte e nevojshme?

PË. Po.

PY. Dhe a keni bërë ndonjë korrigjim apo qartësim lidhur me

këtë deklaratë?

PË. Po, kam bërë.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dua t'ju tregoj dokumentin me numrin e referencës ERN 103543 deri në 103544. Është deklarata e nënshkruar më datë 14 tetor 1021.

PY. Dhe, zonja hetuese, ju e keni këtë dokument edhe të printuar ashtu siç e keni dhe në versionin elektronik.

Megjithatë e keni të printuar si pjesë të dosjes që ju është dhënë.

A mund ta shihni dokumentin që e specifikova pak më parë?

PË. Po, e shoh.

PY. A e njihni këtë dokument?

PË. Po, e njoh.

PY. A mund të na thoni se për çfarë flet ky dokument?

PË. Ky është një dokument i cili shtjellon disa prej korrigjimeve që unë kam bërë në lidhje me deklaratat, me tre deklaratat?

PY. Ky dokument, a përfshin qartësime apo korrigjimet e dokumentit të 2020 që ju tregua pak më parë?

PË. Po. Kështu është.

PY. Duke marrë parasysh këto korrigjime dhe këto sqarime, informacioni i cili përmbahet në deklaratën me datë 29 tetor 2021, me numër identifikimi ERN 084015 deri 084026, [është] i saktë sipas njohurive dhe besimit tuaj më të mirë?

PË. Po.

PY. Dhe informacioni në këtë deklaratë që ka të bëjë me korrigjimet dhe saktësimet, reflekton atë -- çfarë reflekton? Çfarë do t'i thonit juve Gjykatës lidhur me këtë?

PË. Po. Ajo lidhet me atë çfarë shqyrtohet sot këtu.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Atëherë, më lejoni t'i tregoj dëshmitares dokumentin me numër identifikimi ERN 091791 deri në 091792 që mban datën 9 shtator 2020.

PY. Hetuese, ky është dokumenti me nënndarjen 2 në dosjen që keni përpara me dokumentet e printuar. A e shikoni dokumentin në ekran?

PË. Po, e shoh.

PY. A e njeh këtë dokument?

PË. Po, e njoh.

PY. A mund të na thoni se kush e ka shkruar këtë dokument?

PË. Unë e ka shkruar.

PY. Ju lutem, shihni pak nënshkrimin në faqen e dytë me numër reference 091792. A është ky nënshkrimi juaj?

PË. Po, është nënshkrimi im.

PY. A keni patur mundësi që ta rishikoni dhe këtë deklaratë përpara dëshmisë tuaj dhe të tregoni korrigjime ose sqarime që mund të ishin të nevojshme?

PË. Po, e kam rishikuar.

PY. Dhe a keni patur ndonjë sqarim apo korrigjim për të bërë lidhur me këtë dokument?

PË. Po, kisha.

PY. Dhe këto korrigjime dhe qartësime, a janë reflektuar në deklaratën që keni nënshkruar më 14 tetor dhe që sapo ju treguam. Pra, që është dokumenti në nënndarjen 1 të dosjes tuaj dhe dokumenti që mban numrin e referencës ERN 103543 deri në 103544?

PË. Po, korrigjimet janë reflektuar.

PY. Dhe duke marrë parasysh këto korrigjime dhe sqarime, informacioni i dhënë në deklaratën në dokumentin me numër ERN 091791 deri në 091792. A është ky dokumenti i saktë me aq sa dini dhe besoni ju?

PË. Po është.

PY. Informacioni në këtë deklaratë, a reflekton atë çfarë do të thoni ju përpara Gjykatës sot, në qoftë se do të pyeteni lidhur me këtë?

PË. Po, e reflekton.

PY. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani le të kalojmë te dokumenti me numër identifikimi ERN 091927 deri në dokumentin me numër identifikimi ERN 091930, datë 17 shkurt 2020.

PY. Dokumenti është në nënndarjen 4 të dosjes që keni përpara, zonja hetuese. A e shihni këtë dokument në ekran?

PË. Po, e shoh.

PY. A e njihni këtë dokument, e keni parë atë më parë?

PË. Po, e njoh.

PY. A mund të na thoni se kush e ka shkruar këtë dokument?

PË. Unë e kam shkruar këtë dokument.
PY. Dhe të shohim nënshkrimin në faqen e katërt me numër identifikimi 091930. A e dalloni? E njihni nënshkrimin tuaj?
PË. Po, e njoh.
PY. A ju është dhënë mundësia që ta rishikoni këtë deklaratë përpara dëshmisë tuaj dhe të jepni korrigjime ose qartësime të cilat ishin të nevojshme?
PË. Po.
PY. A keni bërë ndonjë korrigjim apo sqarim lidhur me këtë?
PË. Po.
PY. Dhe duke marrë parasysh dokumentin që sapo ju tregua pak më parë sot, me numër identifikimi ERN 103543 deri në 103544 nënndarja 1 bis, a reflekton ky dokument korrigjimet dhe qartësimet që ju dëshironi të bënit?
PË. Po, i reflekton.
PY. Dhe duke i marrë parasysh këto korrigjime dhe qartësime informacioni i cili është dhënë në deklaratën tuaj, në dokumentin me numër identifikimi ERN 091927 deri 091930, a është ai i saktë me aq sa dini dhe besoni ju?
PË. Po.
PY. Informacioni në këtë deklaratë, a reflekton atë çfarë do të thoni sot përpara Trupit Gjykues në qoftë se do të pyeteni lidhur me të?
PË. Po.
ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Data është 2021 nuk është 2020

siç e thashë më përpara.

PY. Tani le të kalojmë në dokumentin në nënndarjen gjashtë në dosjen tuaj, që është dokumenti me numër identifikimi ERN 09532 dhe që ka datën 7 maj 2021. Është dokumenti i cili do shfaqet tani në ekran.

E shikoni dokumentin, hetuese?

PË. Po.

PY. E keni përpara ekranit apo jo?

PË. Po, e kam.

PY. A e njihni, e keni parë më përpara këtë dokument më parë?

PË. Po, e kam parë.

PY. Dhe kush e ka shkruar këtë dokument?

PË. Unë e kam shkruar këtë dokument.

PY. Ju lutem, a mund të shikoni faqen ,4 me ERN numër 095536 dhe, a na thoni në qoftë se e njihni këtë nënshkrim?

PË. Po, e njoh. Ky është nënshkrimi im.

PY. Faleminderit. A keni patur mundësi që ta rishikoni këtë deklaratë përpara sesa të jepni këtë dëshmi dhe të bëni sqarime apo korrigjime të cilat mund të ishin të nevojshme?

PË. Po.

PY. Dhe a keni bërë korrigjime apo saktësime lidhur me këtë dokument?

PË. Jo, nuk kam bërë.

PY. Ky informacion i dhënë në këtë deklaratë, a është i saktë me aq sa dini dhe besoni ju?

PË. Po, është i saktë.
PY. Informacioni në këtë deklaratë a reflekton atë çfarë do të thoni këtu në qoftë se do të merreni në pyetje?
PË. Po, reflekton.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Së fundi, dua që t'i tregoj dëshmitares dokumentin në nënndarjen 8 të dosjes që ka përpara, është dokumenti me numër ERN 095603 deri në 095653, që mban datën 7 maj 2021.

PY. A e keni tani dokumentin të shfaqur në ekranin përpara jush?
PË. Po, e kam.
PY. A e keni parë më përpara këtë dokument?
PË. Po.
PY. A mund të na thoni se kush e ka shkruar këtë dokument?
PË. Unë e kam shkruar.
PY. Dhe a njihni nënshkrimin në faqen 2, me numër ERN 095604?
PË. Është nënshkrimi im.
PY. Faleminderit. A ju është mundësia që ta rishikoni këtë deklaratë përpara dhënies së dëshmisë dhe të tregoni të bëni korrigjime apo sqarime të cilat mund të ishin të nevojshme?
PË. Po.
PY. Dhe a keni bërë korrigjime apo sqarime lidhur me këtë dokument?
PË. Jo, nuk kam bërë.
PY. Informacioni i dhënë në këtë deklaratë, a është ai i

saktë dhe i vërtetë me aq sa dini dhe besoni ju?
PË. Po, është.
PY. Informacioni në këtë deklaratë a reflekton atë çfarë do të thonit sot përpara Trupit Gjykues në qoftë se do të merreshit në pyetje?
PË. Po.
PY. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë fazë, do të doja që të kërkoja që të pranoheshin si prova materiale deklaratat të cilat janë në përputhje me rregullin 154. Në veçanti, ZPS-ja kërkon pranimin si prova të materiale të dokumenteve të cilat u përmendën, përkthimet e tyre dhe provat e tjera të lidhura me ta, siç jepen të detajuar në parashtrimin e Prokurorisë F00363, datë 14 tetor 2021. Po ashtu vërej që provat e shoqëruara, provat në shtojcën 2 të këtij parashtrimi, Prokuroria ka dhënë një përmbledhje koncize që synon që të kërkojë që të pranohen si prova materiale në përputhje me nenin 93 të urdhrit për proceset, për procedurat në Gjykatë në qoftë se --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Siç u tha edhe më përpara nga -- në rastin e z. Rees, neve do ta shtyjmë për më pas pranimin e parashtrimeve, nuk do ta bëjmë tani.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

Tani do të doja të thoja që unë do të vijoj me prezumimin që deklaratat do të pranohen si prova materiale lidhur ose

parë nga këndvështrimi i artikulimit të pyetjeve ose parjes së pyetjeve të Prokurorisë në lidhje me dëshmitaren në fjalë.

Në qoftë se deklaratat nuk pranohen si prova materiale, ZPS-ja do të mundohet që të përfundojë pyetjet e saj për pjesët të cilat trajtohen në deklaratë dhe nuk do të trajtohen, domethënë, do merret me pjesën tjetër të dokumenteve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Ju kërkoj ndjesë. Është e nevojshme për neve që t'i shënjojmë për identifikim. E kuptoj. Pra, është e rëndësishme që të kemi, pra, dokumente të cilat janë shënjuar për identifikim për momentin. Kështu që, Sekretari do ta bëjë këtë gjë dhe kjo do reflektojë gjithashtu dhe në procesverbalin e seancës.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar. ERN 084015 deri në ERN 084026 do t'i jepet kodi P66 MFI. Ndërkohë që dokumenti që është me numër ERN 103543 deri në 103544 do të caktohet me emërtimin P67 MFT. Dokumenti me ERN 091791 deri në 091792 do t'i caktohet identifikimi P68 MFI. Dokumenti me numër ERN 091927 deri 091930 do të caktohet si dokumenti P89 MFI. Dokumenti me numër ERN 095533 deri në 095602 do të identifikohet si dokumenti P90 MFI. Ndërkohë që dokumenti me ERN 095603 deri në 095653 do të caktohet si dokumenti P91 MFI.

Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit z. Sekretar.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Sa i takon provave materiale të cilat sapo janë paraqitur për t'u pranuar në prova, dëshiroj të sqaroj se e kisha fjalën për shtojcën 2 të parashtrimit të protokolluar të Prokurorisë me numër 367 dhe të gjitha provat materiale të cilat përmenden aty.

Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

PY. Hetuese, përmendët sot se keni shqyrtuar dokumente të cilat janë sekuestruar në Organizatën e Veteranëve të Luftës të UÇK-së disa herë. Dëshiroj që të përqendrohem te dokumentet e sekuestruara në ndërhyrjen e parë të ZPS-së në Organizatën e Veteranëve të Luftës.

A ju kujtohet data e sekuestrimit të kryer nga ana e ZPS-së në Organizatën e Veteranëve të Luftës?

PË. Ishte data 8 shtator.

PY. Faleminderit. Si edhe më parë, do të përmend dokumentet e sekuestruara në OVL UÇK nga ZPS-ja datë 8 shtator, si Paketa 1.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A mund të përmendni edhe vitin, ju lutem?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] 2020.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

PY. A mund të thoni sesi keni arritur në një konstatim kur keni shqyrtuar dokumentet që janë sekuestruar nga OVL UÇK-ja më datë 8 shtator 2020?

PË. Doni të thoni se nga ta dija që kam shqyrtuar dokumentet e sekuestruara?

PY. Po. Pikërisht.

PË. Kam shqyrtuar shënimin zyrtar që është hartuar nga individët e përfshirë në sekuestrim. Në atë Shënim Zyrtar përshkruhen hapat e ndërmarrë. Kam shqyrtuar edhe procesverbalin e dorëzimit që është hartuar kur kanë marrë provat dhe kam shqyrtuar edhe parashtrimin e bërë në databazën tonë.

PY. Faleminderit. Dua t'ia filloj duke ju treguar një dokument i cili është nënvijëzuar si ndarja 10 në dosjen që keni përpara me numrin ERN 083988 deri në 083991 RED.

Z. REES: [Përkthim] A mund të bëj një kundërshtim?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

Z. REES: [Përkthim] Ky është një dokument i cili nuk është krijuar nga dëshmitarja. Është një dokument i cili objekti i një kërkese që mbetet ende për t'u pranuar si dorëzimi i provave jo përmes dëshmitarëve. Të nderuar Gjykatës e kanë rrëzuar këtë kërkesë lidhur me këtë dokument në vendimin procedural përkatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Bëtë

keqparaqitje të vogël. Ne e kemi shtyrë në kohë dhe marrjen e vendimit për këtë, nuk është se e rrëzuam.

Z. REES: [Përkthim] Unë, siç e kuptoj unë, të nderuar Gjykatës e kanë rrëzuar parashtrimin e provave përmes, pra, jo përmes dëshmitarëve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sigurisht, e saktë. Kjo është një deklaratë e shtatë, por ne kemi shtyrë marrjen e një vendimi procedural.

Z. REES: [Përkthim] Mendimi procedural për parashtrimin përmes një rruge tjetër e cila do të vijë më pas. Por në lidhje me pranimin e provave jo përmes dëshmitarëve, unë do ta lidhja këtë me dokumentet ku përshkruhen "ngjarjet në të cilat një ose të dy prej të akuzuarve si, apo dhe bashkëpunëtorët e tyre, kanë qenë të pranishëm në disa prej rasteve lidhur me këtë". Kjo është një çështje tjetër e cila mbase do të vij më pas.

"Një prej këtyre raporteve ka për autor një punonjës të ZPS-së që duhet të dëshmojë këtu". Kjo nuk është në raport. "Lidhur sa i takon kësaj, Trupi Gjykues mban parasysh se Mbrojtja duhet të vihet në pozicionin e tillë që të konfrontojë në mënyrë efektive provat dhe të kundërshtojë vërtetësinë dhe besueshmërinë e atyre që janë të regjistruar në këto. Për këtë arsye, Trupi Gjykues, konstaton se pranimi i provave jo përmes dëshmitarëve është i parakohshëm. Trupi Gjykues, për këtë arsye, e rrëzon pranimin e këtyre

materialeve”.

Kjo është sa i takon këtij vendimi procedural dhe është i qartë siç është shprehur këtu. Ky raport është krijuar nga një punonjës i ZPS-së. ZPS-ja ka qenë në gjendje dhe, ende është në gjendje, që ta thërrasë punonjësin përkatës që të dëshmojë këtu sa i takon përmbajtjes së këtij raporti në mënyrë që edhe të mund të kundërshtojmë atë që thotë ai, vërtetësia dhe besueshmëria e asaj që është regjistruar aty duhet që të konfrontohet në mënyrë efektive. Por ZPS-ja nuk e ka pranuar ftesën që ka bërë Trupi Gjykues për të bërë këtë gjë, ata nuk mund që t'u shmangen pasojave të një vendimi të tillë thjeshtë duke u përpjekur që ta parashtrojnë këtë provë për mes këtij dëshmitari, e çka nuk na jep neve mundësi që të kundërshtojmë vërtetësinë dhe besueshmërinë e asaj që regjistrohet aty.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Ne do t'i japim Prokurorisë mundësinë që të bëjë disa pyetje, ju mund të shqyrtoni nëse keni kundërshtim më pas dhe mund të bëni kundërshtimet përkatëse kur t'i bëni kundërpyetjet tuaja dëshmitares së Prokurorisë.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Hetuese, e keni dokumentin në ekran përpara jush?
PË. Po.
PY. Faleminderit. E njihni këtë dokument?
PË. Po, e njoh.

PY. A mund ta lexoni pjesën e sipërme të këtij dokumenti poshtë logos së ZPS-së?
PË. Aty shkruhet “Shënim Zyrtar”.
PY. Dhe në bazë të përvojës tuaj si hetuese e ZPS-së, a mund të na thoni se çfarë është Shënimi Zyrtar?
PË. Shënimet zyrtare janë procesverbale të mbajtura nga hetues, analistë dhe punonjës të llojeve të tjera. Në to dokumentohen aktivitetet në formën e një shënimi zyrtar, siç është ky p.sh., të cilat pastaj dorëzohen në databazën tonë.
PY. A e njihni modularin tip që përdoret zakonisht për shënimet zyrtare?
PË. Ky është modulari tip që ne përdorim.
PY. Kjo që keni përpara?
PË. Po, e saktë.
PY. A nënshkruhen shënimet zyrtare në përgjithësi nga autorët e tyre?
PË. Po.
PY. Sapo përmendët se shënimet zyrtare mbahen në dokumentacionin zyrtar të ZPS-së. A mund ta përshkruani se cili është procesi i dorëzimit të një shënimi zyrtar në dokumentacionin zyrtar të ZPS-së?
PË. Procesi i dorëzimit është i thjeshtë. Ajo që bëjmë ne është hyjmë në -- regjistrohemi, pra, në sistem. Aty plotësojmë disa kuti në mënyrë elektronike. Pastaj japim hollësi se çfarë po dorëzojmë, datën e dokumentit, kush e

dorëzon dhe shkruajmë një përshkrim të shkurtër se çfarë është. Pasi e kemi dorëzuar këtë e printojmë, pra, pasi e kemi dorëzuar formularin e regjistrimit e printojmë. Dhe në këtë rast, zakonisht, marrim versionin e shtypur, shkojmë tek njësia e provave dhe i dorëzojmë të dyja për tu përfshirë në prova. E regjistrojmë atë në një regjistër. Kur e dorëzojmë në mënyrë elektronike, kjo krijon një numër të veçantë dhe ky numër i veçantë pastaj kalon edhe në këtë regjistër që përbën dhe dorëzimin.

PY. Me "Njësitë e Provave" e keni fjalën për Njësinë e Çështjeve dhe të Provave, menaxhimit të – më falni- Njësia e Menaxhimit të Provave dhe të Çështjeve.

PË. Po, ju kërkoj ndjesë. Ky është titulli zyrtar.

PY. Që ndryshe i quajmë edhe CEMU?

PË. E saktë.

PY. Dhe mbasi kopja e shtypur dhe dorëzimi elektronik i dokumentit i çohet CEMU-t, si e përpunon CEMU këtë dokument?

PË. E dorëzojnë si kopje të shtypur e skanojnë dokumentin dhe pastaj e ngarkojnë në databazë, por unë nuk është se e njoh mirë këtë proces. Zakonisht ne u japim këtyre një informacion - në falni - ne u japim dhe versionin elektronik në formë DVD-je, pra, e dorëzojmë provat elektronikisht në format DVD të cilat pastaj ngarkohen në prova.

PY. A e dini se çfarë është numri i referencës së provave pra, ERN?

PË. Çdo provë që ne dorëzojmë merr një numër të tillë. Ose vuloset me dorë ky dokument ose krijohet në mënyrë elektronike.

PY. Kush i cakton këto numra ERN dokumenteve që dorëzohen në prova?

PË. Kjo është njësia CEMU.

PY. Dhe numri ERN a shfaqet në dokument apo regjistrohet në prova?

PË. Kjo është e saktë.

PY. Tani të shikojmë Shënimin Zyrtar që keni përpara dhe mund të më thoni se cili është numri që ka në anën e djathtë sipër?

PË. Në faqen 1 është 083988.

PY. Më falni, hetuese. Desha që t’ju pyes se çfarë lloj numri është ky më saktë? Çfarë tregon? A është numër ERN-je apo jo?

PË. Po.

PY. Dhe fakti se ky dokument është i vulosur me këtë numër ERN-je a do të thotë kjo se është dorëzuar zyrtarisht në databazën e provave të ZPS-së?

PË. Po.

PY. Faleminderit. Po të shikojmë tani temën, lëndën e këtij Shënimi Zyrtar, siç identifikohet në pjesën e sipërme, a mund të na thoni se cila është lënda e këtij Shënimi Zyrtar?

PË. Lënda është “Sekuestrimi i dokumenteve nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së”.

PY. Po të shohim paragrafin 1 të dokumentit, cila është data

e aktiviteteve zyrtare për të cilat flet ky Shënim Zyrtar?
PË. Data është 8 shtator 2020.
PY. Faleminderit. Ju lutem, tani të shihni emrin e autorit të këtij Shënimi Zyrtar siç është paraqitur këtu dhe pa e përmendur emrin e këtij personi në seancë të hapur, a mund t'i thoni Trupit Gjykues, nëse e njihni se cili është autori i këtij Shënimi Zyrtar?
PË. E njoh autorin.
PY. Dhe a mund të thoni se cili është funksioni?
PË. Siç thuhet në Shënimin Zyrtar është oficeri i sigurisë operacionale.
PY. Pra, në seancë publike t'i referohemi autorit të këtij Shënimi Zyrtar me funksionin profesional që ka. Pra, si punonjës i sigurisë së ZPS-së. Ky person a është personel i ZPS-së?
PË. Po.
PY. Dhe autor i këtij Shënimi Zyrtar a ka qenë personel i ZPS-së në 8 shtator 2020?
PË. Po.
PY. Dhe duke qenë se ju vetë jeni personel i ZPS-së, a keni pasur rastin që flisni me autorin e këtij Shënimi Zyrtar lidhur me aktivitetet e kryera më datë 8 shtator 2020?
PË. Po, kam folur me të.
PY. Çfarë informacioni të ka dhënë?
Z. REES: [Përkthim] A mund të kundërshtoj përsëri? Kemi

parë më parë rregullat nga 153 deri në 155 që kanë të bëjnë me provat e dëgjuara nga të tjerë që përmenden në këto rregulla.

Prokuroria po kërkon që të fusë dëshminë e këtij punonjësi sigurie përmes këtij dëshmitari duke bërë pyetje te dëshmitari.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju po kundërshtoni për dëshminë e dëgjuar nga të tretë?

Z. REES: [Përkthim] Kundërshtimi është që po kërkohet anashkalimi, në këtë rast nga Prokuroria, i rregullave 153 dhe 155. Do të doja që të zgjerohesha për këtë lidhur me përgjigjen që kemi në mocion -- që kemi bërë për mocion -- në mocionin tonë -- në përgjigjen tonë - më falni - për mocionin e Prokurorisë për të paraqitur prova jo përmes dëshmitarëve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Unë e kuptoj rregullin. Dhe ju e dini shumë mirë që provat e dëgjuarat nga të tretë pranohen sipas rregullores sonë dhe i takon pastaj Trupit Gjykues që t'i caktojë një peshë dëshmisë në fjalë.

Z. REES: [Përkthim] Ne gjithashtu parashtrojmë se, sigurisht, në juridiksione të tjera, nuk bëhet ndalim absolut i pranimit të dëshmive të dëgjuara nga të tretë. Por ajo që është e qartë këtu si orientim është se edhe pse parashikim ekuivalent i rregullit 138 jep një diskrecion të gjerë për të lejuar prova, kjo nuk do dua që të përdorej për të shmangur pasojën e qartë të rregullave 153, 154 dhe 155, të cilat kanë

të bëjnë me pranimin e deklaratave të dëshmitarëve jo përmes dëshmisë së dhënë në sallë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees, e kuptoj kundërshtimin tuaj. Unë e kuptoj që ajo është për dëshmitë e dëgjuara nga të tretë dhe unë nuk e pranoj kundërshtimin tuaj.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

PY. Hetuese, na thatë pak më parë se keni folur me punonjësin e sigurisë që ka qenë autori i këtij Shënimi Zyrtar lidhur me veprimtaritë e kryera më datë 8 shtator 2020 në bazë të cilësisë së tij zyrtare. A mund t'i thoni Trupit Gjykues se çfarë informacioni morët me atë rast?

PË. Në fakt nuk më kujtohet konkretisht se çfarë pyetjesh i bëra. Mendoj, se më kujtohet, se më duket se e kam pyetur vetëm nëse a i ka vendosur dokumentet në një apo në dy qese provash. Më duket se kjo ka qenë e vetmja gjë për të cilën ne kemi folur.

PY. Dhe kur -- ose nëse do të donit që të dinit informacion më të hollësishëm për aktivitetet e hollësishme të autorit të këtij Shënimi Zyrtar të kryera më datë 8 shtator 2020 cilin dokumentacion do të duhet që të shihnit?

PË. Siç e thashë më parë, ajo që unë shqyrtova ishte ky Shënim Zyrtar dhe procesverbali i dorëzimit i cili është krijuar kur punonjësi i sigurisë i ka sekuestruar provat. Në

atë moment është hartuar një dokument prej një faqe që është nënshkruar nga personi që e ka sekuestruar dhe personi që e ka dorëzuar së bashku më datën dhe orën.

PY. Faleminderit. Do të doja që të lexonim, shumë shkurt, paragrafët nga 2 deri në 6 të Shënimit Zyrtar që keni përpara. Që është në faqen janë në faqen nga 08388 [sipas përkthimit] deri në faqen 89.

PË. Ju kërkojë ndjesë. Ta lexoj pa zë apo me zë?

PY. Pa zë.

Dhe në bazë të dokumentit që keni përpara a mundet që të na thoni se cili prej OVL UÇK-së ja ka dorëzuar punonjësit të sigurisë të ZPS-së dokumentet që janë sekuestruar në datë 8 shtator 2020?

PË. Personi që ia dorëzoj ato ishte z. Faton Klinaku.

PY. Dhe po të shohim paragrafin 6 të kësaj note zyrtare dhe këtu dua t'ju lexoj pjesën përkatëse:

"Një formular ku regjistrohet dorëzimi është nënshkruar nga Faton Klinaku shënuar këtu me shkurtim, pra, F.K. dhe nga punonjësi i sigurisë që këtu sërish është shënuar me shkurtin, pra, vetëm me iniciale.

A e keni parë ndonjëherë notën zyrtare që përmendet këtu?

PË. Po.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj tani t'i tregoj dëshmitarit një dokument me numër ERN-je 08449 deri në 08449, pra, është vetëm një faqe që është dorëzuar tashmë si provë --

është pranuar tani si provë materiale me numër P56

PY. Hetuese, ky dokument është në nënndarjen 11 të dosjes që keni përpara. E keni parë këtë dokument më përpara?

PË. Po, e kam parë.

PY. A mund të na thoni se çfarë është ky dokument?

PË. Kjo është ajo që unë e përmenda si procesverbal i dorëzimit që është përpiluar nga punonjësi i sigurisë kur ka sekuestruar Paketën 1 nga z. Faton Klinaku.

PY. Po forma, pra, modeli i këtij dokumenti a është i njohur për ju?

PË. Po, është një modular tip që përdorim.

PY. A mund të shihni dhe datën që është aty e shënuar?

PË. Data është 8 shtator 2020.

PY. Ju lutem, shihni rubrikën e këtij material -- e këtij formulari që thotë “Dorëzimi”. Kush është aty?

PË. Dorëzuesi. Është z. Faton Klinaku.

PY. Tek marrësi a mund të thoni nëse e njihni emrin e marrësit pa e lexuar emrin?

PË. Është, marrësi është i njëjti punonjësi sigurie i cili ka përpiluar këtë procesverbal dorëzimi siç e përmenda përpara.

PY. A mund të na thoni se çfarë tregon numri në qoshen sipër djathtas të këtij dokumenti 080449?

PË. Kjo tregon se ky dokument është dorëzuar në databazë.

PY. Dhe a mund të na thoni sesi e keni parë fillimisht këtë dokument?

PË. Ky dokumenti ishte dokumenti i parë i paketës që i ishte dorëzuar në ZyLAB, në sistem pra. Për të qenë i qartë është -- ishin ky dokument së bashku me dokumentet e sekuestruara të dorëzuara së bashku në ZyLAB.

PY. Pra, ky si të thuash, është faqja shoqëruese e dokumenteve që ju i keni shqyrtuar dhe na keni thënë që janë paketa 1?

PË. Po e saktë.

PY. Faleminderit. Dëshiroj tani t'i tregoj dëshmitares dokumentet në ndarjen 12 dhe 13, që ka hetuesja në dosje, që janë provat me numër P00057 dhe P00057-ET.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ju lutem, sekretarit që t'i nxjerrë të dyja faqen në ekran njëkohësisht.

PY. Faleminderit. A e njihni këtë dokument, hetuese?

PË. Ju kërkoj ndjesë. Nëse unë kam të njëjtin numër ERN-je siç lexuat edhe ju.

PY. 081340.

PË. Po. Faleminderit.

PY. A shihni të njëjtin dokument në ekran?

PË. Po.

PY. A e njihni këtë dokument?

PË. Po.

PY. Pikë së pari, a mund të na thoni se çfarë tregon numri në pjesën e sipërme djathtas të dokumentit?

PË. Tregon që edhe ky dokument është dorëzuar në prova.

PY. A mund të na thoni se përse bën fjalë ky dokument?
PË. Ky dokument, mua më duket, se është një shënim i dhënë nga z. Faton Klinaku kur janë sekuestruar dokumentet, pra, është një shënim i shkruar me dorë.
PY. Mund të na thoni se cila është data e dokumentit?
PË. Data është 8 shtator 2020.
PY. Faleminderit. Kur e keni parë për herë të parë këtë faqe?
PË. Kjo faqe ishte faqja e fundit e paketës që ishte dorëzuar në prova.
PY. Cila paketë?
PË. Ju kërkoj ndjesë, Paketa 1.
PY. Pra, ju po thoni që dokumenti që keni përpara në ekran është faqja e fundit e pirgut të dokumenteve që është sekuestruar nga OVL UÇK-ja më datë 8 shtator 2020?
PË. Po, e saktë.
PY. Faleminderit. A mundet apo a ju kujtohet se cili ishte numri i ERN-së së dokumenteve të Paketës 1 që keni shqyrtuar?
PË. Ju kërkoj ndjesë, unë numrin s'e mbaj mend por e kam shkruar në shënimet e deklaratës që më duket është dorëzuar të premten. Duhet t'i shoh.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I kërkoj leje Trupit Gjykues, që ta lejojë dëshmitaren të konsultohet me shënimet e saja, të cilat janë njoftuar Trupit Gjykues dhe Mbrojtjes paraprakisht përpara dëshmisë në sallë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

DËSHMITARJA: Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mos e lexoni thjesht referohuni atyre, mbajeni shënim dhe prokurorja do të bëjë pyetje për to.

DËSHMITARJA: Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

PY. A ju kujtohet, hetuese, numri ERN-së të Paketës 1 që keni shqyrtuar?

PË. Po, mund ta shoh.

PY. A mundet ta thoni këtë numër ERN-je të dokumenteve që keni parë?

PË. Numri ERN është 080450-081340 dhe 080449-080449.

PY. Në rregull. Dhe...

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj. Bolici ka ardhur momenti për të bërë pushim.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mbase mund ta rifillojmë menjëherë këtë pas pushimit në orën 11.30 të gjithin.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem shoqëroheni dëshmitaren të dalë nga salla.

DËSHMITARJA: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund t’i marr dokumentet me vete apo mund t’i lë dokumentet?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

Bëjmë ndërprerje këtu deri në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 11.02 paradite

--- Seanca rifillon në orën 11.30 paradite

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Uluni ju lutem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare, silleni përsëri dëshmitaren.

Shoh që nuk ka ndryshim në përbërjen e ekipeve që janë të pranishme në sallën e gjyqit.

[Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Keni kërkuar fjalën, z. Cadman?

Z. CADMAN: [Përkthim] Shumë shkurt, i nderuar Gjykatës, sa për t’i kujtuar Gjykatëse dy mocione që u dorëzuan dje. Do ta vlerësonim nëse do t’i trajtonit sot, sepse mendojmë se ka rëndësi. Nuk do i diskutoj se njëri është parashtrim konfidencial. Tjetra që dua të them është se nguroja të ngrihesha sa herë, herë pas here kur dëshmitarja po jepte dëshmi. Ne i kemi përsëritur kundërshtimet. Ne i kemi pritur dëshminë e sotme, nuk ka është dhënë shpjegim i duhur se pse paraqiten dëshmitarë në Gjyq, dëshmitarë të Prokurorisë që kanë njohuri të drejtpërdrejtë. Ne e dimë që ju keni dhënë vendim për propozimin e z. Rees, por neve e rinovojmë, e ri përsërisim kundërshtimin tonë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] E morëm shënim. Mund të vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Të vazhdojë aty ku e lamë para pushimit. Ju na thatë përpara pushimit, hetuese, se Nota Zyrtare, dokumenti që ju treguam, me numër ERN 080449 ishte faqja e parë e dokumenteve të paketës 1 që keni shqyrtuar dhe se dokumenti me numër ERN 081340 ishte faqja e fundit e dokumentit të paketës 1 të cilat ju i keni shqyrtuar.

E kuptoni saktë që numri ERN i dokumentit që ju keni shqyrtuar përfshihet në gamën e këtyre dy dokumenteve me numër ERN.

Pë. Po.

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Përpara se të kalojmë te përmbajtja e dokumenteve që ka shqyrtuar hetuesja, të nderuar Gjykatës, kërkoj që pranohet si provë Nota Zyrtare me numër ERN 083988-083991RED. Duke pas parasysh se është me rëndësi, sepse ka të bëjë me ngjarje të ndodhura në 8 shtator, ka vlerë provuese dhe është provuar me numrin W083841 [sipas përkthimit] gjatë dëshmisë sonë. Faleminderit

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Edhe një herë, kërkesën tuaj për pranim do ta lëmë për më vonë. Mund, zonja Sekretare, caktojini numra këtyre dokumenteve.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky numër është P91, shënuar për identifikim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

Faleminderit. Vazhdoni, zonja Prokurore.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Një korrigjim. Në fakt numri do të jetë P92, shënuar për identifikim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] E mbajtëm shënim korrigjimin. 92, shënuar për identifikim.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Hetuese, t'i kthehemi përmbajtjes së dokumenteve që u sekuestruan në OVL UÇK në 8 shtator 2020, që po i quajmë si paketa 1. A mund të na përshkruani në përgjithësi përmbajtjen e tyre?

Pë. Një pjesë e madhe e dokumenteve që përmbante paketa 1 janë kërkesa për koordinim të ofruara nga Task-Forca Speciale Hetimore, pra ndihmë në hetime, nga Prokurori serb i Krimeve të Luftës, i zyrës për krime lufte. Pra, ka të bëjë me komunikime midis Prokurorit serb për Krimet e Luftës dhe njësive të ndryshme, apo stacioneve të ndryshme policore. Pra, bëhet fjalë për komunikim të brendshëm kur Prokurori i kërkonte policisë të zhvillonte hetime. Për shembull, të gjente dëshmitarë apo të merrte deklarata, dhe policia pastaj raportonte e kthente përgjigje, jepte materialet e kërkuara.

Py. Faleminderit. Ju thatë se janë kërkesa për koordinim, pra janë kërkesa të TFSH-së për çështje penale, kështu është?

Pë. Ashtu është.

Py. Që nga 8 shtatori, procesverbalet e TFSH-së janë bërë publike, të këtyre hetimeve penale?

Pë. Me sa di unë jo.

Py. Si anëtare e stafit të ZPS-së, cili është klasifikimi i procesverbaleve apo i dokumenteve të hetimeve penale në çështje penale të TFSH-së ZPS.

Pë. Janë dokumente konfidenciale.

Py. Kërkesa për ndihmë për çështje penale nxjerrë nga TFSH-ja dhe ZPS-ja, a janë pjesë e këtyre dokumenteve të hetimeve apo procesverbalit të hetimeve?

Pë. Ju lutem ma përsërisni edhe një herë pyetjen.

Py. Ju thatë më herët se procesverbalet apo të dhënat e hetimeve të TFSH-së dhe ZPS-së janë konfidenciale. Pyetja është kërkesat për ndihmë në çështje penale, janë edhe ato pjesë e dokumenteve të hetimeve të ZPS-së, janë edhe ato konfidenciale?

Pë. Po. Janë edhe ato konfidenciale.

Py. Si anëtare e stafit të ZPS-së, jeni e autorizuar, jeni e lejuar t'i nxirrni këto dokumente palëve të treta, pra kërkesat për ndihmë për çështje penale, këtyre kërkesave të TFSH-së apo ZPS-së?

Pë. Jo.

Py. Dhe si anëtare e stafit, a jeni e autorizuar, e lejuar tua bëni të njohur palëve të treta, pra jo anëtarëve të ZPS-së, hollësitë apo detajet e personave që kanë kryer zbatimin e kërkesave për ndihmë në çështje penale të nxjerra nga TFSH-ja apo ZPS-ja?

Pë. Jo, nuk jam.

Py. Faleminderit. A ju kujtohet afërsisht sa kërkesa për koordinim janë përfshirë në dokumentet e sekuestruar në OVL UÇK në 8 shtator të vitit 2020?

Pë. Për saktësi, më duhet t'i referohem dokumentit, spreadsheet-it pra, të 8 majit në qoftë se më lejon Trupi Gjykues?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po janë pjesë e paketës 1.

Py. Dua t'i tregoj dëshmitares dokumentin me numër ERN 080464, që është dokumenti me numër 14 të nën-ndarjes që e keni përpara. A keni përpara në ekran dokumentin?

Pë. Po.

Py. E keni parë këtë dokument më përpara?

Pë. Po e kam parë.

Py. Në parë konteksti e keni parë këtë dokument?

Pë. Ky dokument ishte një nga dokumentet e sekuestruara si pjesë e paketës 1.

Py. Faleminderit. Ju lutem lexoni titullin e dokumentit, fjalinë -- në qendër, ato që janë me të zeza.

Z. REES: [Përkthim] Më herët ju na thatë që mund të ngremë çështje që kanë të bëjnë me mungesën e nxjerrjes së dokumenteve në kohën që përmendet në dokument dhe ne mendojmë që nuk është bërë kjo nxjerrje.

Unë nuk besoj që ky dokument është në listën e provave materiale të propozuara nga ZPS-së për t'u përdorur me këtë

dëshmitar. Nuk kam kundërshtim në këtë fazë të procedurës, por do të kërkoja nxjerrjen e tij dhe një pushim të shkurtër ku ne të mund të mund të diskutojmë me njëri-tjetrin për të ecur më tej.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ta pyes Prokurorin.

Është në listë?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është në listë. Më lejoni një minutë dhe do ta tregoj referencën e saktë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem, bëjeni.

Dokumenti 483? Ky dokument është? 483?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Pra dokumenti 483, e keni z. Rees?

Z. REES: [Përkthim] Në rregull. E kemi.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Ju lutemi lexojeni titullin e dokumentit që është me të zeza në qendër të dokumentit.

Pë. Dokumenti lexon: "Kërkesë për koordinim, nr. 95"

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani kërkoj që të kalojmë në seancë private sepse na duhet të marrim informacion dhe ky është dokument konfidencial.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Për të

mbrojtur informacionin konfidencial, do të kalojmë seancë private.

Sekretar, të lutem të kalojmë në seancë private.

kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ *Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Hetuese, a mund të na thoni nëse Kërkesa për Koordinim nr. 95 ka të bëjë me hetimet e TFSH-së apo të ZPS-së ?

Pë. Po. Mund ta konfirmoj.

Py. Nga e dini ju këtë?

Pë. Po është një model standard dhe në anën e majtë lart ka logon -- emblemën e TFSH-së, ka referencën, numri i çështjes është aty, pasqyrohet në çdo komunikim të kësaj natyre. Pastaj është edhe data. *[REDAKTUAR] në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.* kur u krijua edhe kjo TFSH-ja dhe ajo që shkruhet është teksti i zakonshëm për këtë lloj kërkesash për koordinim.

Py. Përveç mënyrës sesi është ndërtuar dokumenti, pra modelit të hartimit të dokumentit që na përshkruat, dua t’ju tërheq vëmendjen te përmbajtja e këtij dokumenti.
Lidhur me paragrafin e parë, a mund të na thoni se çfarë lloj kërkese shprehet aty? Pra si është ky dokument që i është drejtuar Prokurorit të Krimeve të Luftës së Republikës Serbe në paragrafin e parë të kësaj kërkese për koordinim?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

Py. Këto lloj kërkesa për ndihma në çështje penale, a janë këto pjesë e hapave hetimore që ndërmerren normalisht nga TFSH-ja apo ZPS-ja?

Pë. Kjo ka ndodhur në fakt përpara se sa unë të filloja punë aty, por kam parë shumë kërkesa të tilla edhe kjo është një kërkesë e zakonshme e tillë.

Py. Faleminderit. Të shohim paragrafin e dytë tani, të kësaj kërkese. A mund të na thoni se çfarë përmban kjo kërkesë, pra ky paragraf drejtuar nga TFSH-ja kësaj zyrës së Krimeve të Luftës?

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

Py. Faleminderit. A përshkruhet këtu aktiviteti, veprimtaria e hapave të zakonshme hetimore të ndërmarra nga TFSH-ja apo ZPS-ja?

Pë. Në rastin e TFSH-së po.

Py. Faleminderit. Lidhur me paragrafin e tretë, a mund të na thoni se për çfarë bën fjalë ky paragraf i kërkesës?

Pë. Paragrafi i fundit i referohet një kërkese tjetër për koordinim, 87-a dhe këtu kërkohet nga TFSH-ja, i kërkon autoriteteve serbe të thërrasin disa dëshmitarë që më pas do të intervistoheshin nga TFSH-ja në një periudhë të përcaktuar kohe.

Pë. Faleminderit. Kërkesa për ndihmë për të dëgjuar provën e dëshmitarëve, apo dëshminë e dëshmitarëve, a janë këto pjesë e hapave hetimore që normalisht ndërmerr TFSH-ja apo ZPS-ja në veprimtarinë e tyre hetimore?

Pë. Me sa kuptoja unë në atë kohë, asistenca apo ndihma kishte të bënte vetëm me gjetjen dhe thirrjen e dëshmitarëve dhe jo intervistimin e tyre.

Py. Këto lloj kërkesash a janë pjesë e hapave hetimore të zakonshme të ndërmarra nga TFSH-ja dhe ZPS-ja?

Pë. Po, është një tekst shumë standard që e kam parë në shumë kërkesa të ngjashme.

Pë. Faleminderit. A keni verifikuar, hetuese, nëse këto kërkesa për koordinim gjenden në bazën e të dhënave të ZPS-së, të të dhënave zyrtare hetimore?

Pë. Po, e konfirmoj se këtë dokument e kam parë në bazën e të dhënave dhe është regjistruar.

Py. A mund të na thoni si e keni bërë këtë kontroll?

Py. Në këtë rast, kam bërë një kërkim në bazën e të dhënave, ZyLAB, dhe me siguri dhe me numrin e kërkesës dhe ka dalë dokumenti. Kështu kërkoj dokumente të tilla.

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mund të kalojmë përsëri në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Të kalojmë përsëri në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Zonja Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Hetuese, po të shohim numrin ERN në anën e djathtë të dokumentit, pra, mund të na thoni -- 080464. Ky numri ERN është vënë përpara apo pas sekuestrimit të paketës nr. 1 të dokumenteve të paketës 1, në OVL UÇK?

Pë. Mbas.

Py. Kur dokumentet u sekuestruan në zyrat e OVL UÇK, kishte numër ERN?

Pë. Që të jemi të qartë, ta shpjegoj. Dokumenti i sekuestruar, pra të gjitha kërkesat për koordinim të sekuestruara kanë numër regjistrimi. Ishte aty. Ndodhej aty numri.

Py. Nuk e kuptova mirë përgjigjen. Të gjithë dokumentet e sekuestruar kishin një numër ERN? Në këtë rast, për shembull, 080464, ky numër i është vënë përpara apo ishte aty?

Pë. Ju vu numri kur ne i futëm në sistem, në ZyLAB.

Py. Pra, përpara parashtrimit të dokumenteve të sekuestruara, dokumentet nuk kishin numër ERN-je?

Pë. Jo, nuk kishin. Nuk e kuptova mirë.

Py. Ju na thatë që identifikuat një kopje të kërkesës për koordinimi, atë me numër 95, kur u ndërmor shqyrtimi i këtyre dokumenteve në bazën e të dhënave.

Pë. Është e saktë.

Py. Këto dokumente që ju i identifikuat, a e kanë numrin ERN?

Pë. Po, e kanë.

Py. Numri ERN i dokumenteve të identifikuara prej jush në bazën e të dhënave të provave, a del ai në -- te dokumentet që janë sekuestruar në OVL UÇK në 8 shtator?

Pë. Dokumentet e sekuestruara apo dokumenti që unë gjeta në bazën e të dhënave ka një numër ERN. Kurse dokumentit që ne sekuestruam ju vu një vulë me një numër tjetër.

Py. Bazuar në përvojën tuaj, çfarë informacioni mund të nxirrni nga ky ndryshim në numrat e ERN?

Pyetja është: dokumenti që u sekuestrua apo dokumentet, ishin kopje me vulë, pra dokumente me vulë, të vulosura, siç ishin në bazën e të dhënave?

Pë. Dokumentet e sekuestruara në OVL UÇK ishin të njëjtë me përjashtim që nuk kishin vulën.

Py. Tani dua t'i tregoj dëshmitares një dokument me numër ERN 095533-095602. Është deklaratë e 7 majit të vitit 2021 dhe dua

t'i referohem konkretisht Shtojcës 1 të kësaj deklarate, që fillon me numër ERN 095537, nën-ndarja 6 e dokumenteve të keni përpara.

Py. E keni përpara?

Pë. Po. Faleminderit.

Py. Po të shohim Shtojcën 1 të kësaj deklarate, që fillon me numër ERN 095537, a e keni përgatitur ju këtë tabelë?

Pë. Po.

Py. A mund të na shpjegoni shkurtimisht se çfarë informacion keni përfshirë në këtë tabelë?

Pë. Tërheq vëmendjen tek titujt e tabelave, ndarjeve, numrin e faqes, gjuhën, llojin e dokumentit, titullin e dokumentit, përshkrimin e dokumentit, datën dhe burimin apo autorin e dokumentit. Në fund është emri. Them që është edhe konfidencial, ku përfshihen emrat e dëshmitarëve të mundshëm.

Pë. Faleminderit. Po të shohim faqen e dytë, me numër ERN 095538 shikoni ju lutem te shënimi 2 i fundit në këtë faqe. A mund të na thoni se cili është titulli i dokumentit që përshkruhet në këtë rresht të tabelës?

Pë. Titulli është "Letër" me listën bashkëngjitur të dëshmitarëve.

Më fal, nuk shoh lart titullin. Është kërkesa për koordinim numër 95, "Lista e dëshmitarëve, 9 mars 2015".

Py. Më këtë rresht të tabelës, e keni shënuar dokumentin që diskutuam? Dokumentin me numër ERN 080464, pra "Dokument për

koordinimin nr. 95”?

Pë. Po, është e saktë.

Py. Mbështetur në shënimin që ka -- përfshin kjo shtojcë, a mund të na thoni nëse dokumentet e shqyrtuara prej jush në paktën e parë të përfshirë me faqen e parë të kërkesës për koordinim që është një faqe tjetër e bashkëngjitur këtu?

Pë. Përfshinin, po, një shtojcë.

Py. A mund të na shpjegoni se si e merrni -- mësoni informacionin?

Pë. Sepse shkruhet në llojin e dokumentit. “Letër” me bashkëngjitur listën e dëshmitarëve. Në kolonën e parafundit thuhet që bashkëngjitet lista e dëshmitarëve.

Py. Faleminderit. Dua që të shikoni kolonën që përshkruan titullin e dokumentit, në kllapa, përfshirë titullin e shtojcës. Në lidhje me rolin që ka të bëjë me kërkesën, lexon “Kërkesa për [e pad] nr. 95 (Lista e Dëshmitarëve e 9 marsit të vitit 2015)”. A mund të na thoni se çfarë përfshihet aty, çfarë tregon kjo?

Pë. Kjo kërkon -- që një pjesë e kërkesës ishte pjesë 95 dhe se kishte edhe një shtojcë, një listë me dëshmitarë. Data është 9 mars.

Py. Në rregull. Në qoftë se do të shikojmë faqen e fundit, në këtë kërkesën për koordinim, 95. Unë shoh që ju keni bërë këtë shënimin, po që ky është një informacion me emrat e dëshmitarëve të mundshëm të cilët përfshihen në dokumentet që

keni shqyrtuar ju. A keni verifikuar nëse kërkesa e koordinimit 95 ose bashkëlidhjet e tij, përfshijnë emra dëshmitarësh ose të dëshmitarëve potencialë.

Pë. Po.

Py. A na shpjegoni dot ju lutem se si e keni bërë shqyrtimin tuaj lidhur me këtë pikë dhe çfarë informacioni përfshihet apo reflektohet në kolonë, sa i takon emrave të dëshmitarëve ose të dëshmitarëve potencialë?

Pë. Unë do ta kem shqyrtuar kërkesën për koordinimin për emrat dhe do të kem kontrolluar të paktën një emër sepse volumi ishte i konsiderueshëm. Pra do kem kërkuar të paktën një emër për të përcaktuar në qoftë se ky person ishte i regjistruar apo jo në listën globale të dëshmitarëve dhe në qoftë se i ishte bashkëlidhur një numër dëshmitari. Dhe po ashtu do kem parë në qoftë se person ishte i intervistuar apo jo dhe në qoftë se kishte ndonjë shënim sa i takon takimeve të organizuara me të. Pra këtë lloj informacioni do të kem marrë dhe në qoftë se përgjigja do kishte qenë pozitive do kem shkruar në këtë kolonë "po", domethënë ky është procesi i zakonshëm i punës.

Py. Faleminderit. Atëherë ju lutem shikoni kolonën që ka të bëjë me sugjerimin për natyrën konfidenciale të dokumentit. Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen në veçanti lidhur me komentin që "letra i referohet listës së bashkëlidhur të dëshmitarëve." Ju lutem, a mund të na shpjegoni se çfarë lloj informacioni

jeni munduar të reflektoni në këtë pjesë të tabelës?

Pë. Këtu i referohem letrës së parë, le të themi, të kërkesës për koordinim dhe në fakt formati është standard. Thuajse është gjithmonë një bashkëlidhje e cila pason dhe e cila ka të bëjë me listën konfidenciale të dëshmitarëve, një faqe të tillë.

Py. Dhe ju gjithashtu verifikoni që ky informacion, ky shënjimi "konfidencial" ishte edhe në letrën e parë.

Pë. Po, në qoftë se deklarohet, ose thuhet kështu në këtë kolonë, do jetë bërë ky si veprim.

Py. Dua që të shkojmë shkurtimisht te dokumenti me numër identifikimi ERN 080464, nën-ndarja 14. Ju lutem shihni rreshtin që është menjëherë poshtë nënshkrimit që është në cepin në të djathtë të dokumentit. A mund të lexoni se çfarë thuhet në këtë rresht?

Pë. Në këtë rresht thuhet "bashkëlidhje [KONFIDENCIALE] dhe "Lista e dëshmitarëve datë 9 mars 2015".

Py. Kur ju përshkruani në tabelën tuaj shënimet konfidenciale si për shembull bashkëlidhet lista konfidenciale e dëshmitarëve, a e shikoni këtë në lidhje me kërkesën e koordinimit 95?

Pë. Po, kështu është.

Py. Përveç kërkesës për koordinim, 95, a ka kërkesa të tjera për koordinim të përfshira në paketën nr. 1 të cilat përfshijnë listat e dëshmitarëve që do të intervistoheshin nga

TFSH-ja?

Pë. Po, ka disa.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj t'i kthehem edhe një herë dokumentit me numër identifikimi ERN 095537. Atëherë, bëhet fjalë për dokumentin që fillon me 095533-095602. Tani në qoftë se do të kalojmë te faqja me numër identifikimi ERN 095538.

Py. Dua t'ju kërkoj që të shikoni rreshtin e dytë nga fillimi i faqes që i referohet faqes 10-11. Ju lutem a mund të lexoni se cili është titulli i këtij dokumenti?

Pë. Titulli është "Kërkesë për Koordinim nr. 96".

Py. A mund të na tregoni ju lutem se sa faqe është Kërkesa për Koordinim nr. 96?

Pë. Dy faqe.

Py. A mund të na thoni në qoftë se kjo kërkesë koordinimi ka përfshirë një listë të bashkëlidhur ku përfshiheshin emrat e dëshmitarëve?

Pë. Po.

Py. Si e dini këtë gjë?

Pë. Mund ta shoh te përshkrimi i llojit të dokumentit. Thuhet që është "Letër me një bashkëlidhje" dhe e shikojmë këtu edhe titullin e shtojcës dhe po ashtu sugjerohet edhe natyra konfidenciale e këtij dokumenti, pasi flitet për listën e dëshmitarëve.

Py. Në qoftë se do të shikojmë kolonën që sugjeron natyrën

konfidenciale të dokumentit. A keni shënuar edhe këtu që letra i referohet një liste konfidenciale dëshmitarësh?

Pë. Po, kështu është.

Py. A do të thotë kjo që kërkesa e koordinimit nr. 96 ka të njëjtin shënjim konfidencial siç ishte rasti për kërkesën e koordinimit nr. 95?

Pë. Po, kështu është.

Py. Lidhur me kolonën që ka të bëjë me emrat e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve potencialë. Unë lexoj që ju keni shkruar "po" në këtë dokument. A keni bërë të njëjtin lloj verifikimesh të cilat ju na shpjeguat pak më parë lidhur me Kërkesën e Koordinimit nr. 95 dhe për Kërkesën e Koordinimit nr. 96?

Pë. Po.

Py. A keni dhënë kampionë që sugjerojnë natyrën konfidenciale të dokumentit dhe të cilat përfshihen në paketën nr. 1.

Pë. Po.

Py. Dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj te dokumentet -- një dokument, i cili e ka titullin Shtojca 2 dhe është i përfshirë në dokumentet nën dokumentet me numër identifikimi ERN 095590-095594.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për Sekretaren e seancës, është i njëjti dokument, vetëm thjesht po shohim një faqe tjetër të të njëjtit dokument.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, ky është dokumenti i cili do të përmbajë tashmë numrin e

referencës P45 [sipas përkthimit].
Py. Hetuese, a mund të na thoni ju lutem se çfarë informacioni keni reflektuar sa i takon shtojcës 2 të kësaj deklarate?
Pë. Shtojca 2 është një mori indiciesh të cilat nënkuptojnë konfidencialitetin që përmbahen në dokumentet të cilat janë sekuestruar nga paketa nr. 1.
Py. Pra, duke pasur parasysh indiciet që sugjerojnë informacion konfidencial, të cilat janë dhënë në dokumentin -- germën D në faqen 095591. A keni izoluar këtu informacionin konfidencdial ose shënjimin "Konfidencial" që do kishim vënë re ndryshe në Kërkesën e Koordinimit 95?
Pë. Po e kam dokumentuar atë këtu.
Py. A mund të na përshkruani ju lutem se çfarë lloj shënjimi konfidencial keni identifikuar nën germën e, menjëherë më poshtë?
Pë. Është shënjimi për informacionin konfidencial të lidhur me dëshmitarët.
Py. E ku dalin ose ku duken, ose ku shfaqen shënime të tilla konfdidenciale, kryesisht? Në kërkesë, në shtojcë, diku tjetër?
Pë. Në shtojcë.
Py. Pra, sa herë që ju i referoheni shënimit konfidencial në tabelën tuaj, ju verifikoni që ka një shënim konfidencial të të njëjtit lloj, siç e ilustruat përmes këtij dokumenti nën

germën e. A është kështu?
Pë. Po, kështu është.
Py. Sa i takon shënjimit konfidencial nën germën c, a mund të na thoni se çfarë lloj shënjimi konfidencial keni përcaktuar këtu?
Pë. Germa c është shënjim konfidencial, është një tekst i cili është i integruar në kërkesë.
Py. Ju keni bërë një fotografim të kërkesës për koordinim që thuhet, ku specifikohet që bëhet fjalë për natyrë konfidenciale të hetimeve. A nuk është kështu?
Pë. Po kështu është.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani kalojmë te tema tjetër. Do t'i kërkoja Sekretares të na tregojë provën materiale me numër identifikimi ERN 081083RED, që është dokumenti 15 në dosjen që keni përpara.

Pë. A e keni shqyrtuar më përpara, e keni parë më përpara këtë dokument?
Pë. Po.
Py. Në çfarë konteksti e keni shqyrtuar këtë dokument?
Pë. Ky dokument është po ashtu një prej dokumenteve që është sekuestruar nga OVL-ja e UÇK-së.
Py. A keni verifikuar në qoftë se është përfshirë në dokument korrespondues në provën shkresore -- pra provat materiale të ZPS-së?
Pë. Po.

Py. A është përfshirë?

Pë. Po, është përfshirë.

Py. A mund të identifikoni lidhur me këtë dokument ndonjë bashkëlidhje që ka të bëjë me ndonjë listë dëshmitarësh?

Pë. Ky dokument i referohet një dokumenti të bashkëlidhur.

Py. Nuk referon apo preferon?

Pë. Është dokumenti i cili thotë -- kërkon "Me respekt që TFSH-ja të shqyrtojë individët -- të marrë në pyetje të cilët janë të listuar në bashkëlidhjen si dëshmitarë në Serbi më 27 mars".

Py. Faleminderit.

Pë. Në vitin 2014.

Py. Faleminderit. Tani le të kalojmë te një tjetër dokument. Dokumentin me numër identifikimi ERN 080992, në nën-ndarjen 16.

A e keni shqyrtuar më përpara këtë dokument?

Pë. Po, e kam shqyrtuar.

Py. A është pjesë e paketës nr. 1 ky dokument?

Py. Po, është.

Py. A keni verifikuar në qoftë se ka një dokument korrespondues që është ngarkuar në provat shkresore të ZPS-së?

Pë. Po.

Py. A shihni ndonjë referencë që të bëjë me një dokument të bashkëlidhur, ku përfshihen listat e dëshmitarëve?

Pë. Jo.

Py. A mund të lexoni nga faqja e parë e këtij dokumenti në qoftë se ky dokument i referohet ndonjë dëshmitari ose dëshmitari potencial?
Pë. Po, thotë emrat e një dëshmitari ose dëshmitarit potencial.
Py. Në rregull. Në këtë rast, a keni identifikuar në qoftë se emri i përfshirë në këtë kërkesë koordinimi ishte ndërmjet dëshmitarëve ose dëshmitarëve potencialë të TFSH-së ose të ZPS-së?
Pë. Po, dhe mund ta konfirmoj.
Py. Dhe ky informacion do të reflektohej në shtojcën 1 të deklaratës në tabelën që pamë më përpara.
Pë. Po, mendoj po.
Py. Faleminderit.
ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dëshirojmë të kalojmë te dokumenti tjetër, dokument me numër identifikimi ERN 080565.
Py. A e keni parë më përpara këtë dokument?
Pë. A mund të më thoni se cila nën-ndarje është?
Py. Kërkoj ndjesë, është nën-ndarja 17 në dosjen që keni përpara.
Pë. Po, e kam parë këtë dokument.
Py. A është ky dokument pjesë e paketës nr. 1?
Pë. Po, është.
Py. A keni verifikuar në qoftë se ky dokument, në qoftë se një dokument korrespondues është pjesë e bazës së të dhënave

të provave shkresore të ZPS-së.

Pë. Po dhe është i përfshirë.

Py. Dua të tërheq vëmendjen tuaj te lista e emrave e përfshirë në paragrafin e fundit të këtij dokumenti. Tani, një moment ju lutem, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen për përshkrimin e këtij dokumenti. Pra përshkrimin që keni dhënë te tabela e hartuar prej jush.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do t'i kërkoj Sekretarit të tregojë edhe një herë në ekran dokumentin me numër identifikimi ERN 095533-0955602. Dua që të shkojë veçanërisht te faqja 085548, në qoftë se mund ta shfaqni në ekran. Ju kërkoj ndjesë, është faqja 095545.

Py. Ju lutem shihni rreshtin e katërt të kësaj faqeje, e cila i referohet dokumentit me titull "Kërkesë për Koordinim nr. 113 [sipas përkthimit]", në veçanti shihni informacioni që keni regjistruar te kolona Emrat e Dëshmitarëve Potencialë. Lexoj që lidhur me kërkesën për koordinim numër 113 [sipas përkthimit] ju keni shënjar që kjo kërkesë për koordinim nuk përfshin emrat e ndonjë dëshmitari. A është e saktë kjo?

Pë. Po, kështu është. E saktë.

Py. Faleminderit. Së fundi, dua që të tregohet dokumenti me numër identifikimi ERN 081031, që është nën-ndarja 18 e dosjes që keni përpara.

A e keni parë më parë këtë dokument?

Pë. Po, e kam parë.

Py. Dhe a është ky dokument pjesë e paketës nr. 1
Pë. Po, është.
Py. A keni verifikuar në qoftë se një dokument korrespondues, përkues, i kësaj kërkese për koordinim është përfshirë në bazën e të dhënave të provave të ZPS-së?
Pë. Po, dhe mund të konfirmoj që është i ruajtur në bazën e të dhënave të ZPS-së.
Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në këtë fazë dua që të kërkoj që të regjistrohen si prova materiale dokumentet të cilat dëshmitarja sapo i vërtetoi që janë të vërteta dhe posaçërisht këto janë dokumentet që cilët mbajnë numrin e identifikimit ERN 090464 deri në 080464, dokumenti me numër identifikimi ERN 0955 -- jo ndjesë, një sekondë, dokumenti me numër identifikimi ERN 081083 deri në 081083RED, dokumenti me numër identifikimi ERN 080992 deri në 080992 dhe dokumenti me numër identifikimi ERN 08103 deri në 08103. Të gjitha këto janë me rëndësi, janë provuese në natyrë dhe janë identifikuar nga dëshmitari si dokumente të cilat janë sekuestruar nga paketa nr. 1 nga OVL-ja e UÇK-së.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ndonjë kundërshtim? Zoti Rees?

Z. REES: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Trupit Gjykues që ta shtyjë këtë vendim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Nuk ju

ndjek, ma shpjego edhe një herë?

Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se mund të shtyni pranueshmërinë e këtyre dokumenteve dhe të mund ta lini këtë për në fund të dhënies dëshmi të dëshmitares.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mirë në rregull.

Prokuroria çfarë mendon?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Pozicioni i Prokurorisë është që për këtë dokumente të cilat janë vërtetuar në gjykatë nga dëshmitari, nuk ka arsye për t'u shtyrë vendimi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] E kuptoj, e kuptoj.

Atëherë këto janë shënuar për identifikim?

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i parë në rend kronologjik me ERN 080464 do të shënjohet me shënjimin P93 MFI. Dokumentit të dytë 081083 do t'i caktohet kodi P94MFI, dokumentit tjetër me numër ERN-je 080992 do të marrë P95 MFI, dokumenti 080565 do të marrë numrin e dokumentit P96 MFI, dhe dokumenti i fundit, 081031 do të marrë emërtimin P97 MFI. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit, zoti Sekretar.

Zonja Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregoj dëshmitares dokumentin që është pranuar si provë materiale me numrin

P0001-ET që është, hetuese, dokumenti në nën-ndarjen 20 në dosjen që keni përpara.

Do t'i kërkoja Trupit Gjykues që të kalonim shkurtimisht në seancë private për pyetje që kanë të bëjnë me këtë dokument.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Për çështje konfidencialiteti, Gjykata do të kalojë në seancë private.

Përderisa kjo është një video, Prokurore, mund të flisni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në fakt, dua që t'i referohem transkriptimit. Mbase nuk e citova siç duhet, bëhet fjalë për dokumentin me numër identifikimi P0001 ET.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë nuk na duhet një seancë e mbyllur apo private dhe dokumenti është pranuar, apo jo?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]

Py. A mund të na thoni më me hollësi se në çfarë lloj dokumenti është përfshirë apo keni parë një informacion të tillë, domethënë një informacion konfidencial, dokument i llojit tjetër. Mund të thoni diçka lidhur me të?

Pë. Nga sa mbaj mend, them që ky emër është përmendur në kërkesën koordinuese, por ju kërkoj ndjesë se nuk mund të them dot me saktësi në qoftë se ishte pjesë e kërkesës konfidencaile apo pjesë e një teksti më të përgjithshëm.

A mund të verifikoni në qoftë se informacioni i përfshirë në paketën nr. 1 përfshin gjithashtu edhe titullin profesional të personit që përmendet në këtë transkript.

Pë. Në qoftë se e mbaj ,end siç duhet, po. Po, ishte i përfshirë edhe titulli dhe besoj se do ta kem deklaruar edhe në deklaratën time kështu që në qoftë se mund t'i kthehem, mund ta them me siguri.

Do ju kërkoja, të nderuara Gjykatës, që t'i lejoni dëshmitares që të shikojë deklaratën e saj. Është deklarata e datës 29 tetor i vitit 2020, është deklarata me numër identifikimi ERN 084015 deri në 084026.

Të nderuar Gjykatës, dua vetëm një konfirmim nëse jemi apo jo në seancë private?

Kisha kërkuar pak më herët që të kalonim në seancë private, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Dëshironi që të jeni në seancë private?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Sekretar, kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

Py. Faleminderit. Lexoj në paragrafin 10 të deklaratës suaj këtu. Keni thënë se informacionet dhe të dhënat vetjake janë të përfshira në shtojcat konfidenciale të kërkesave të ndryshme lidhur me dëshmitarë të ndryshëm që SITF-ja, pra TFSH-ja kërkon që të intervistojë.

A mund të na thoni -- a mund të konfirmoni, më saktë, që emrat dhe të dhënat e këtyre individëve janë të përfshira në shtojcat e kërkesave për koordinim?

Pë. Po, e konfirmoj.

Py. Faleminderit.

Pak më herët përmendët se krahas kërkesave për koordinim, paketa 1 përfshinte edhe lloje të tjera dokumentesh. Afërsisht a mund të thoni se sa dokumente bëjnë pjesë në këtë kategori të dytë?

Pë. E kam harruar shifrën por mendoj se është mbi 100.

Py. Faleminderit.

Të nderuar Gjykatës, mund të kalojmë në seancë publike sërish.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Sekretar, ju lutem të kalojmë në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Zonja Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. A mund të na thoni se në ç'gjuhë janë këto dokumente?

Pë. E keni fjalën për dokumentet serbe?

Py. Po.

Pë. Serbishte.

Py. Dhe këto dokumente a janë të përshkruara në tabelën që është shtojca 1 e deklaratës suaj ku përshkruani dokumentet e paketës 1?

Pë. I përshkruaj si dokumente në anglisht edhe ato serbishte pa dallim.

Py. Dokumentet në serbisht, a përfshijnë emrat e individëve?

Pë. Po.

Py. A keni kontrolluar dokumente në serbishte nëse këta individë janë -- bëjnë pjesë pra në dëshmitarët faktikë apo të

mundshëm të TFHS-së?
Pë. Po.
Py. Dhe kur keni parë se kanë bërë pjesë këta dëshmitarë, a e keni treguar këtë gjë për secilin dokument të informacionit përkatës si "po" në tabelën që i është bashkëlidhur deklaratës suaj si shtojca 1?
Pë. Po.
Py. A mundët ju të identifikonit në dokumentet serbishte përmendjen e -- faktin pra që është përmendur shprehimisht TFHS-ja apo kërkesat për ndihmë në hetimet penale të cilat TFHS-ja i ka drejtuar autoriteteve kompetente serbe?
Pë. Po, kam parë që përmenden kërkesat e TFHS-së, në dokumentet në gjuhen serbe.
Py. Dhe a e keni shënuar këtë informacion në tabelën që është shtojca 1 e deklaratës suaj?
Pë. Po.
Py. A keni vënë re nëse dokumentet serbe përfshijnë deklarata që kanë dhënë dëshmitarët apo dëshmitarët e mundshëm?
Pë. Po, ka deklarata dëshmitarësh apo dëshmitarësh të mundshëm.
Pë. A keni verifikuar në rastin e këtyre deklaratave, nëse individi që ka dhënë deklaratën ka qenë faktikisht dëshmitar ose dëshmitari i mundshëm i TFHS-së apo i ZPS-së?
Pë. Po.
Py. Dhe kur sipas kontrollit tuaj, rezultati ishte pozitiv, a

e keni bërë të ditur këtë informacion me fjalën “po” në shtyllën përkatëse të shtojcës suaj me “Emrat e Dëshmitarëve të Mundshëm”?

Pë. Po.

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkhtim] Dëshirojmë t’i tregojmë tani dëshmitares dokumentin me numër ERN-je 091909 deri në 091917RED.

Py. Është tabela 22 e dosjes.

E keni dokumentin përpara?

Pë. Po.

Py. E njihni këtë dokument?

Pë. Po.

Py. Kush është autori i këtij dokumenti?

Pë. Unë jam.

Py. Çfarë lloj dokumenti është ky?

Pë. Është Notë Zyrtare.

Py. Cili është qëllimi i kësaj Note Zyrtare?

Pë. Qëllimi ishte që të dorëzoheshin emailet që zyra jonë ka marrë -- përfshiheshin pra në prova, në ZyLAB.

Py. Si i keni marrë këto emaile?

Pë. Këto emaile m’i ka përcjellë personi i përmendur në Notën Zyrtare. Unë i printova, i regjistrova si dorëzim në sistemin ZyLAB, duke dorëzuar këto emaile, bashkë me Notën Zyrtare, për t’u përfshirë në prova.

Py. Dhe a keni folur me personin që jua ka përcjellë këto emaile lidhur me materialin që jua kanë përcjellë?

Z. REES: [Përkthim] Përpara se të përgjigjet dëshmitarja, të nderuar Gjykatës kemi një kundërshtim të ngjashëm me përmbajtjen e këtij raporti dhe përmbajtjen e emaileve që janë vendosur në dispozicion dhe me pyetjen që i bëhet dëshmitares për të përsëritur se çfarë i është thënë. Unë mbështetem te ajo që ka thënë Trupi Gjykues pak më përpara lidhur me vendimin procedural, unë nuk do ta çoja më tej për momentin por dua vetëm që të mbahet shënim kundërshtimi ynë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Është mbajtur shënim kundërshtimi juaj, të cilit i bashkohet edhe zoti Cadman.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. A keni folur me personin që jua ka përcjellë këto emaile në momentin kur ju është vendosur në dispozicion materiali?

Pë. Nuk më kujtohet nëse kam folur me të. Më duket se kam [e pakuptueshme] vetëm emailin që i përcillte këto emaile.

Py. Faleminderit. Ju lutem shihni tani faqet me numër 091915. Jeni familjarizuar me përmbajtjen e kësaj korrespondence?

Pë. Po, i kam lexuar të gjitha këto emaile.

Py. A mund të më thoni se përse bëjnë fjalë këto emaile, shkurtimisht?

Py. Është një email që e dërgon një media lajmesh, ja dërgon zëdhënësit tonë, që bën fjalë për rrjedhje të paketës 1 në

thelb.

Py. A mund të shikoni tani në faqen me numër 091917? A mund të na thoni edhe në këtë rast se për se bën fjalë kjo korrespondencë?

Pë. Është një email tjetër që bën fjalë për rrjedhjen e paketës 1.

Py. A jeni në dijeni pas kësaj korrespondence që ZPS-ja ka qenë apo jo në kontakt me autorin e këtyre emaileve?

Pë. Po, me sa kam dijeni, autori i këtij emaili na ka vënë në dispozicion paketën 4.

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj që t’i dërgoj dëshmitares dokumentin me numër ERN 083986 deri në 083987RED që është në ndarjen 23 të dosjes që keni përpara.

Z. REES: [Përkthim] Dëshirojmë që të bëjmë kundërshtim që të mbahet shënim dhe të trajtohet në momentin e duhur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] U mbajt shënim.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. A e keni parë këtë dokument më përpara, hetuese?

Pë. Po.

Py. A mund të na thoni se ç’lloj dokumenti është?

Pë. Është Notë Zyrtare.

Py. A mund të na thoni nëse është dorëzuar në dokumentacionin zyrtar të ZPS-së?

Pë. Po.
Py. Pa përmendur emrin, a mund të thoni nëse e dini se kush është autori i kësaj Note Zyrtare?
Pë. Po, e njoh autorin.
Py. Me çfarë funksioni profesional?
Pë. Është punonjës sigurie.
Py. A është i njëjti person i cili ka kryer sekuestrimin nga OVL UÇK-ja në datë 8 shtator 2020.
Pë. Po.
Py. A mund të na thoni se çfarë veprimtarie dokumentohet në këtë Notë Zyrtare?
Pë. Veprimtaria e dokumentuar në këtë Notë Zyrtare është marrja e paketës 4 nga gazeta InFokus.
Py. Dhe a mund të thoni se kur është bërë dorëzimi i këtyre dokumenteve.
Pë. Më datë 9 shtator.
Py. Të cilit vit?
Pë. Kërkoj ndjesë, të vitit 2020.
Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj tani që t'i tregojmë dëshmitares dokumentin me numër 078569 deri në 078569 që është në nën-ndarjen 24 të dosjes që keni përpara.

Py: [Pa përkthim].
Pë: [Pa përkthim].
Py: [Pa përkthim].

Pë. Ky është dokumenti që është përpiluar kur i është dorëzuar paketa ZPS-së.

Py. A mund të thoni që dokumenti që ka përpiluar -- më falni që personi që ka dorëzuar dokumentet në këtë rast është edhe autori i dy emialeve që pamë më përpara?

Pë. Po, e konfirmoj.

Py. Dhe a mund të thoni, a mund ta shihni në bazë të këtij dokumenti pra nëse marrësi i këtyre dokumenteve është autori i Notës Zyrtare që pamë para pak?

Pë. E konfirmoj.

Py. Nëse shohim rubrikën e materialeve, aty ku shkruhet "Ref", a mund ta shohim se çfarë lloji dokumentesh janë dorëzuar?

Pë. Këtu thuhet "Dokumente që janë dorëzuar Gazetës inFokus".

Py. Dhe në rreshtin tjetër, sa i takon përmbajtjes, a mund të thoni se çfarë materialesh bëhen të ditura aty, nga rreshti i dytë?

Pë. Thuhet "Dokumentacioni nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së".

Py. A i keni shqyrtuar dokumentet që ZPS-ja ka marrë nga gazeta inFokus më datë 9 shtator të vitit 2020, të cilat ju i përmendni, apo të cilave i referoheni si paketa 4?

Pë. Po.

Py. A mund të thoni nëse këto dokumente kishin apo jo fletë-shoqëruese?

Pë. Më kujtohet se është e njëjta si në paketën 1, pra që ishte në pjesën e sipërme. Është pikërisht ky dokumenti i dorëzimit që ishte sipër dokumenteve të tjerë.

Py. A ju kujtohet numri ERN që ju është caktuar dokumenteve që janë marrë nga gazeta inFokus më datë 9 shtator të vitit 2020?

Pë. A mund të shoh deklaratën time për të gjetur numrin ERN, i nderuar Gjykatës?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Po, patjetër.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për të qenë të qartë, i nderuar Gjykatës, hetuesja po sheh shënimet e saj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Po.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Pra, a mund të na thoni numrin ERN që i është caktuar dokumenteve të paketës 4 të cilat i keni parë?

Pë. Ju kërkoj ndjesë se nuk pashë të duhurin. Ju kërkoj ndjesë, nuk pashë numrin që duhej të shihja. Paketa 4 është regjistruar me numër 078570 deri në 079499.

Py. Tani që patë ERN e dokumentit që është përpara jush që është dokumenti i dorëzimit, a mund të thoni nëse ky dokument i dorëzimit është fleta shoqëruese apo ndryshe e quajtur ballina e paketës 4?

Pë. Po.

Py. A ishte ballina?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ishte kjo pyetja?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po ishte pyetje.

Py. A është fleta ballinë e paketës 4?

Pë. Me regjistrimin 078569 është numri që sapo unë thashë, pra 078570. Kjo i bie që të jetë edhe fleta ballinë.

Py. A mund të përshkruani në përgjithësi se çfarë lloj dokumentesh përmban paketa 4?

Pë. Paketa 4 është shumë ngjashme me paketën 1. Siç e dëshmova në deklaratën e datës 8 maj, në shtojcën 1 të dokumenteve të paketës 4 ka vetëm disa, pra pak dokumente që janë të ndryshme nga paketa 1.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshirojmë që t’i tregojmë dëshmitares deklaratën me numër 095603 deri në 095653 që është ndarja 8 e dokumenteve që keni përpara.

Py. Në veçanti nëse shohim faqen me numër ERN-je 095605, a mund të na thoni se çfarë lloj informacioni keni përfshirë në këtë tabelë?

Pë. Kam përfshirë të njëjtin informacion që kam përfshirë edhe për paketën 1, me përjashtim se këtu kemi edhe dy shtylla të tjera, njëra është faqet korresponduese me paketën 1 dhe dallimet midis paketës 1 dhe paketës 4.

Py. Faleminderit. Po të shohim shtyllën që mban titullin “Faqet Korresponduese” në paketën 1, a mund të shpjegoni çfarë lloji informacioni përfshin kjo dhe si e keni bërë krahasimin

midis paketës 1 dhe paketës 4?

Pë. Siç duket këtu, përbërja kur ndryshonin, për shembull midis paketës 1 dhe paketës 4, përbërja mund të ndryshonte dhe ishte e lodhshme për ta gjurmuar, për ta ndjekur. Prandaj edhe më lindi ideja për të përfshirë këtë shtyllë.

Py. Dhe a mund të na dalloni se çfarë dallimesh keni përfshirë apo për çfarë bën fjalë shtylla e fundit, dallimet midis paketës 1 e paketës 4?

Pë. Nëse mund të konsultohem, të shikoj dokumentin tim për të parë shembuj të ndryshëm në këtë shtojcë?

Po, këtu kam dokumentuar kur ka dallime të tilla për shembull, kur nëse një kërkesë koordinimi përbëhej nga dy faqe, paketa 1 mund të kishte letrën she shtojcën ndërkohë që paketa 4 s’e kishte shtojcën. Pra këto lloj dallimesh, mospërputhjesh i kam dokumentuar këtu.

Ose ajo që mund të shoh këtu, për një arsye ose një tjetër, ndonjëherë dokumentet e njërës paketë ishin më të lexueshme se paketa tjetër ose nëse ishin të palexueshme, e përfshij edhe këtë fakt.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Faleminderit. Për ta mbyllur këtë, e kam kuptuar qartë se sa herë që një faqe e paketës 4 përfshihej edhe në paketën 1, në shtyllën -- faqen korresponduese në paketën 1, ju keni treguar se për cilën faqe të paketës 1 -- me cilën faqe të paketës 1 përkon kjo.

Pë. Po.
Py. Dhe në rastet kur nuk kishte një përkitje të tillë, a e keni treguar këtë në shtyllën Faqet Korresponduese?
Pë. Nuk e kuptoj pyetjen tuaj.
Py. Sa herë që faqet përkojnë midis paketës 1 dhe paketës 4, ju keni treguar se cilat faqe të paketës 1 përkojnë me faqet e paketës 4. Çfarë keni shkruar ju në këtë shtyllë kur nuk ka asnjë korrespondencë, kur nuk përkojnë faqet midis paketës 1 dhe paketës 4?
Pë. Po më pyesni se çfarë do të shkruaja në këtë shtyllë?
Pë. Po.
Pë. Nuk më kujtohet ndonjë gjë konkretisht por mund ta shoh dokumentin.
ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua t'i tregoj dëshmitares shumë shkurt faqen me numër ERN 095612, dhe në veçanti rreshtin e dytë dhe të tretë. Shoh se këtu keni shkruar "Faqet nuk janë përfshirë" në shtyllën që thotë "Faqet korresponduese të paketës 1". Pra e kam kuptuar qartë që sa herë që nuk kishte faqe, pra sa ishin në paketën 4 nuk kishte faqe që përkonin me paktën 1, ju keni shkruar "Faqet nuk janë të përfshira".
Pë. Po.
Py. Pra përveç rasteve kur keni shkruar "Faqe nuk është e përfshirë" keni shkruar numrin përkatës të faqes në paketën 1 që përkon me faqen përkatëse të paketës 4.
Pë. Po.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit. Duke parë orën mendoj se është momenti i duhur për të bërë pushimin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Tani do të bëjmë pushimin.

Ju lutem ta shoqëroni dëshmitaren të dalë nga salla, dhe do të ri kthehemi në orën 14.30, sepse është pushimi i drekës.

Zonja Pumper, mos flisni me askënd sa i takon dëshmisë suaj.

DËSHMITARJA: [Përkthim] E kuptoj.

[Dëshmitarja përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Do të rishihemi të gjithë në orën 14.30. bëjmë këtë ndërprerje tani.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.28 pasdite

--- Seanca rifillon në orën 14.30 pasdite

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH:[Përkthim] Siç na kujtoi z. Rees më përpara Paneli do të japë urdhër me gojë për të dyja këto kërkesa. Por së pari do t'i jap fjalën Avokatit të z. Gucati dhe të z. Haradinaj. Do ju kërkoja që argumentet tuaja t’i formulonit në mënyrë të tillë që të mos nxirrni informacione konfidenciale të asnjë pale.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar. Pozicioni i ZPS-së është që mocionet, të cilat janë depozituar nga Mbrojtja e z. Haradinaj vonë mbrëmë janë të pabazuar dhe duhet të rrëzohen. Sa i takon protokollimit me numër të

identitetit ERN F00377, ZPS-ja vëren se të gjitha citimet të cilat janë referuar nga Mbrojtja e Haradinaj janë marrë nga deklarata e hapjes e Prokurorit të Specializuar, të cilat janë ofruar në kuadër të deklaratës hapëse të ZPS-së. Dhe janë në dorë të Prokurorisë, kështu që nuk është se ka ndonjë arsye që pse të mos riprodhohen pjesëza të cilat janë të botuara në faqen e Internetit të Zyrës së Prokurorit.

Sa i takon kërkesës së Mbrojtjes për të përjashtuar parashtrimin e protokolluar me numër F00374, ZPS-ja vëren që neni 6(2)i Kodit të Sjelljes Profesionale dhe për Mbrojtjet dhe Prokurorin parashikon se Avokati Mbrojtës duhet që të përjashtohet kur ka të ngjarë që ai të thirret si dëshmitar. Ndërkohë që mundësia hipotetike e Avokatit që të thërritet që të japë dëshmi nuk bie brenda fushës së veprimit të Kodit të Sjelljes Profesionale.

Ndërkohë sa i takon Mbrojtjes së Haradinaj, Avokati i z. Haradinaj ka qenë pjesë e kësaj çështjeje që prej shtatorit të 2020-s. Dhe të dhënat për Mbrojtjen e Haradinaj i janë bërë atij të disponueshme që prej prillit të vitit 2021. Këtu i referohem paketës së nxjerrjes së informacionit me numër 25. Avokati i z. Haradinaj i referohet që nuk -- thotë që nuk është i përfshirë në listën tentative të dëshmitarëve të Mbrojtjes, ndërkohë që, ka pak gjasa, nuk ka gjasa fare që ky Avokat do të thërritet për të dhënë dëshmi në këtë fazë, në këtë pikë të procesit.

Z. REES: [Përkthim] Neve mbështesim dhe miratojmë parashtrimet e kolegut, të z. Cadman lidhur me këto dy dosje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë kemi dy parashtrime me gojë, dy urdhra gojorë.

Urdhri i parë ka të bëjë me dokumentin F374.

Më 17 tetor, Mbrojtja për z. Haradinaj ka depozituar kërkimin që të përjashtohet një prej Prokurorët e Asociuar nga procesi, nga procedimi aktual dhe arsyet ndërkohë janë dhënë në kërkesën e Prokurorit të Asociuar dhe thua që kjo është pjesë e ushtrimit të detyrave të tij dhe si rezultat personi mund të thërritet si dëshmitar lidhur me rrethanat në të cilat është marrë informacioni përkatës. Baza ligjore për sa i takon kërkesave janë neni 6(2)i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe dispozita të caktuara të Kushtetutës së Kosovës. Neni 62 dhe 63 të Rregullores, neni 6(2) i Sjelljes në Procedura.

Paneli, Trupi Gjykues gjen që kjo është një kërkesë, e cila është parashtruar jashtë kohës së parashikuar dhe të nevojshme dhe nuk ka themel.

Ndërkohë ky është një dokumentacion që është bërë i disponueshëm që më 28 prill 2021. Në këto rrethana dhe në ushtrim të detyrimeve të veta, Mbrojtjes i është kërkuar që të parashtrojë kërkesat në përputhje me rregullin 117(2)përpara fillimit të çështjes në përputhje me afatin kohor për Trupin Gjykues për mocione të tilla brenda datës 17 shtator 2021. Nuk

ka arsye, të cilat janë dorëzuar sa i takon shtyrjes së parashtrimit të kësaj dosje.

Duke qenë që mocioni nuk është parashtruar brenda afatit të përcaktuar, Mbrojtja nuk ka të drejtë që të parashtrojë kërkesë në këtë kohë.

Së dyti, kërkesa nuk ka themel dhe Mbrojtja nuk ka arritur që të përcaktojë arsyet, të cilat e bëjnë të qenësishme shqyrtimin e kësaj kërkese.

Si rezultat kërkesa e z. Haradinaj rrëzohet dhe ky është fundi i vendimit gojor.

Ndërkohë urdhri i dytë gojor ka të bëjë me dokumentin F377.

Më 17 tetor 2021, Mbrojtja e z. Haradinaj parashtroi kërkesë në përputhje me rregullin 62-63 të Rregullores. Në këtë kërkesë, Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykues të urdhërojë një përmbledhje të deklaratës hapëse të Prokurorit, i cili është i botuar më datë 16 tetor 2021, në faqen e Internetit të DHSK-së.

Mbrojtja nuk e ka prodhuar njoftimin për shtyp dhe pasi e ka shqyrtuar përbërjen e këtij njoftimi për shtyp Trupi Gjykues është i bindur që kjo deklaratë për shtyp thjesht përbën një përmbledhje të asaj çfarë Prokurori i Specializuar ka thënë më datë 7 tetor 2021. Përmbajtja e deklaratës është pjesë e kuadrit dhe e përgjegjësive të ZPS-së dhe është në përputhje të plotë me regjimin ligjor. Ajo nuk përfshin asnjë

lloj citimi cilësie që do të bie në konflikt me të drejtën e të Akuzuarit për tu prezumuar i pafajshëm. Por, në fakt ajo kërkon që të bëjë një përmbledhje të fakteve, të cilat kanë të bëjnë me rrethanat e çështjes. Dhe për këto arsye Trupi Gjykues e gjen këtë kërkesë pa themel dhe si rezultat e hedh poshtë atë.

Z. Cadman, fjala për ju.

Z. CADMAN: [Përkthim] Thjesht sa për të shmangur ndonjë dyshim lidhur me çështjen e parë të trajtuar nuk kishte ndonjë sugjerim që kishte të bënte me faktin që personi në diskutim, pra mund të bëjë një dëshmitar në këto procedura gjyqësore. Thjesht do të doja të sqaroja pozicionin e Mbrojtjes së Haradinajt lidhur me këtë çështje.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen midis tyre]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë u kujtova z. Rees që ju jeni bërë pjesë e kërkesës dhe dua t'ju them që kërkesa e depozituar në emër të klientit tuaj dhe ajo është rrëzuar.

Z. REES: [Përkthim] Po e kuptova këtë z. Gjykatës.

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë më tej me dëshminë tuaj.

Znj. Prokurore, fjala për juve.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

Shkurtimisht përpara se të fillojmë me pyetjet dua të them për procesverbal që ZPS-ja po ashtu kërkon pranimin në prova materiale të disa dokumenteve, të cilat i janë treguar dëshmitares përpara pushimit, si dokumente të cilat janë provuese dhe që janë vërtetuar nga dëshmitarja. Flitet specifikisht për dokumentet me numrin e regjistrimit ERN 09190 deri në 09197RED, 083986 deri në 083987 dhe dokumenti me numër ERN 078569-078569.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta shtyjmë vendimin lidhur me bashkë me vendime të tjera, dhe do të shënojmë provat materiale si të identifikuara.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës. Dokumentet në gamën ERN091909 deri në 0910917RED do të identifikohen si dokumente të P98 MFI. Ndërkohë dokumentet e shënuara me numrin e identifikimit ERN 083986 do të shënohen si P99 MFI. Ndërkohë që dokumenti i tretë me numrin ERN nga 078569 do të shënohen me numrin P100 MFI.

Faleminderit të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. U shënuan. Tani mund të vijoni znj. Prokurore.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Dëshiroj që dëshmitari të shikojë dokumentin e identifikuar me numrin e identifikimit ERN 08399 që është pjesë e Nënndarjes 26bis në dosjen që keni përpara znj. Hetuese.

Znj. Hetuese, a e keni parë këtë dokument më përpara?
Pë. Po, e kam parë.
Py. A mund të na thoni se për çfarë flet ky dokument?
Pë. Ky është një Shënim Zyrtar i një kolegut tim, i cili ka dokumentuar, që ZPS-ja d.m.th. ka marrë një dokument, ka marrë një email nga Euronews-i Shqipëri sa i takon rrjedhjes së dokumentacionit.

Z. REES: [Përkthim] Dua që të bëj një kundërshtim si më përpara. Pra dua që Gjykata ta shohë, ta konsiderojë atë dhe të marrë pjesë, të vendosë për të lidhur me të në momentin e përshtatshëm.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]
Py. A i keni parë emailet, të cilat i janë bashkëlidhur këtij Njoftimi Zyrtar?
Pë. Po.
Py. A mund të na thoni ju lutem n.q.s. ky Njoftim Zyrtar është i regjistruar në të dhënat zyrtare të ZPS-së?
Pë. Po.
Py. Pse e thoni këtë?
Pë. Sepse unë kam bërë ngarkimin e këtij Njoftimi Zyrtar në ZyLAB.
Py. Faleminderit. Ju lutem a mund të shikoni dokumentin me numër identifikimi ERN 084000 deri në 084001RED. Është në nënndarjen 17 në dosjen që keni përpara. Më falni Nënndarja 27.

A e keni parë këtë dokument më parë?
Pë. Po, e kam parë.
Py. A është ky dokumenti bashkëlidhur në Njoftimin Zyrtar që e pamë para pak minutash?
Pë. Po.
Py. A i keni parë fotografitë që kanë qenë ngjitur në këtë e-mail?
Pë. Po.
Py. A i keni trajtuar, a i keni rishikuar përmbajtjet e këtyre fotove, fotografive gjatë përgatitjes për këtë deklaratë?
Pë. Po.
Py. Dhe a e mbani mend se çfarë përmbajnë fotografitë që janë bashkëlidhur këtij emaili?
Pë. Kishte kampionë që bashkëlidheshin në këtë email, që ishin pjesë e dokumenteve që kishin rrjedhur.
Py. Dua që dëshmitarja të shikojë deklaratën e saj me numër identifikimi ERN 091927 deri në 091930. Në veçanti dua që të shikoj faqen 091929. Është nënndarja 4 në dosjen që keni përpara.
Ju lutem shihni paragrafët nga 14 deri në 20, në faqen nga 091929 deri në 091930.
Në këtë pjesë të deklaratës tuaj a i jeni drejtuar fotografive që janë bashkëlidhur emailet që sapo e pamë para pak minutash?
Pë. Po.

Py. A mund të thoni n.q.s. përshkrimi i dokumenteve që bashkëlidhet në fotografi jepet nga paragrafi 15 deri në paragrafin 20?
Pë. Po, ashtu është.
Py. A keni verifikuar n.q.s. dokumentet që përkonin me fotografitë që ishin bashkëlidhur në email përkonin me faqet që ishin pjesë ose të Paketës 1 ose të Paketës 4?
Pë. Po.
Py. A e keni përfshirë këtë informacion në paragrafët që i përmenda pak më përpara, pra në paragrafët përkatës të kësaj deklarate?
Pë. Po.
Py. A mund të verifikoni që këto janë dokumente që janë përfshirë në Paketën 1 ose në Paketën 4?
Pë. Po.
Py. Dua që të kërkoj leje ose pranim për dokumente, të cilat sapo i pamë, të cilët janë dokumentet me numër identifikimi ERN 083999 deri në 083999 dhe - një moment ju lutem – po është dokumenti 08400 deri në 084001RED.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem shënojini për identifikim për këto dokumente.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti i parë me numër identifikimi ERN 083999 do të marrë emërtimin P01 MFI [sipas përkthimit], dokumenti tjetër ERN 084000 deri në 084001 do të caktohet si dokumenti P102 MFI.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit z. Rees. A prezumoj që vendimi për pranueshmërinë e këtyre dokumenteve është shtyrë për një moment tjetër?

Z. REES: [Përkthim] Po, kjo është.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Tani dua që të kalojmë tek analiza, tek rishikimi që ju keni bërë lidhur me Paketën 2. A mund të na shpjegoni pak ju lutem se çfarë kuptimi ka shkurtimi Paketa 2?

Pë. Kur flas për Paketën 2 unë i referohem dokumenteve që janë sekuestruar nga OVL-ja e UÇK-së. Flas për Paketën e Dytë të dokumenteve, të cilat janë sekuestruar.

Py. A e mban datën mend?

Pë. Nuk e mbaj mend datën tamam.

Py. A do ishte e saktë po të thosha që ka qenë data 17 shtator 2020?

Pë. Po, aq ishte data.

Py. Ju lutem a mund të na thoni se si keni përcaktuar që dokumentet janë dokumentet që keni parë juve, pra që bëhet fjalë për ato dokumente që janë sekuestruar nga OVL-ja e UÇK-së më datë 17 shtator 2020?

Pë. Përdora të njëjtën metodë siç përshkrova për Paketën 1. Unë shqyrtova Njoftimin Zyrtar për mënyrën sesi oficerët e kanë bërë përshkrimin sa i takon sekuestrimit të dokumenteve dhe gjithashtu rishikova edhe dokumentacionin për dorëzimin nga përfaqësuesi i Organizatës së Veteranëve të Luftës për

stafin tonë.
Py. Dhe duke i marrë hap pas hapi të gjitha ato që keni bërë, ju thatë që rishikuat, pra të dhënat zyrtare të ZPS-së sa i takon sekuestrimit. A është kështu?
Pë. Po, kështu është.
Py. A jeni konsultuar me të dhënat zyrtare të ZPS-së sa i takon vendit të dokumenteve ku gjendeshin d.m.th. dokumentet, të cilat janë sekuestruar nga OVL-ja e UÇK-së më 17 shtator, dhe a ishin të futura ato në qese plastike përkatëse?
Pë. A mund ta bësh edhe njëherë pyetjen se nuk e kuptova?
Py. A i rishikove të dhënat zyrtare të ZPS-së sa i takon dorëzimit të dokumenteve që ishin sekuestruar dhe a mund të verifikoni që ato ishin të futura në qese plastike si prova?
Pë. Unë rishikova Njoftimin Zyrtar dhe çfarë ishte lexuar atje, d.m.th. atë mund të lexoje aty.
Py. A mund të lexonit juve dokumente të cilët ishin sekuestruar dhe që ishin futur në qese duke u ruajtur kështu si prova?
Pë. Po, ashtu ishte.
Py. A mund të verifikoni mbështetur në informacionin zyrtar të ZPS-së n.q.s. kishte qese provash, të cilat u dhanë në Njësinë e Menaxhimit të Provave apo CEMU?
Pë. Po, ashtu ishte.
Py. A e verifikuat dorëzimin e provave apo dokumenteve dhe çfarë numra identifikimi ERN i janë përcaktuar këtyre

dokumenteve?

Pë. Po, e bëra këtë gjë.

Py. A verifikoni që numrat ERN të dokumenteve që juve rishikuat ishin të njëjtët numra të cilët ishin dhënë dokumentet që ishin sekuestruar nga OVL-UÇK-së?

Pë. Po.

Py. Dua të kalojmë të njëjtat hapa sa i takon dokumenteve për të cilat neve folëm sot më herët në kuadër të Paketës 1. Lidhur me Paketën 1, a mund të verifikoni që dokumentet e sekuestruara nga OVL e UÇK-së më 8 shtator 2020 ishin vendosur nga oficeri që ka kryer sekuestrimin në qese provash për sa i takon, d.m.th. të dhënave për t'u bërë të dhëna zyrtare të ZPS-së.

Pë. Po.

Py. A mund të verifikoni n.q.s. këto qese provash që përmbanin dokumentet e sekuestruara janë dorëzuar në Njësinë e Menaxhimit të Provave?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem mos iu përgjigj për një moment.

Nuk e di n.q.s. keni ndonjë pyetje, z. Buckley.

Z. BUCKLEY: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë të nderuar, po Prokurorja po bën pyetje të cilat nuk mund t’i përgjigjet dot dëshmitari.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

Z. BUCKLEY: [Përkthim] Si rezultat d.m.th. ajo nuk mund

të komentojë diçka të tillë.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne po bëjmë pyetje, të cilat kanë të bëjnë me provat e sekuestruara nga ZPS-ja.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. A verifikuat që dokumentet, të cilat janë të sekuestruara më 8 shtator 2020 janë dorëzuar në CEMU të ZPS-së?

Pë. Po.

Py. A mund të verifikoni mbështetur në të dhënat zyrtare të ZPS-së që dokumentet që janë sekuestruar më 8 shtator janë pranuar si prova materiale dhe që kanë marr një numër ERN-je?

Pë. Po.

Py. A mund të verifikoni që dokumentet që keni rishikuar si pjesë e Paketës 1 kishin të njëjtin numër ERN-je si dokumentet, të cilat janë ofruar si prova, si dokumente të cilat janë marrë nga OVL-ja e UÇK-së më 8 shtator 2020?

Pë. Të lutem a e përmend dhe njëherë? E thua edhe njëherë?

Py. A mund të verifikoni që dokumentet e sekuestruara nga OVL-ja e UÇK-së më 8 shtator kanë marrë një numër ERN dhe që dokumentet e marra janë dokumente, të cilat e kanë këtë numër ERN-je dhe janë të njëjtat dokumente që janë sekuestruar?

Pë. Po, e konfirmoj këtë gjë.

Py. Faleminderit. Kalojmë tek Paketa 4. A mund të verifikoni mbështetur në dokumentet zyrtare të ZPS-së që dokumentet, të cilat janë marrë nga mediat, kanalet mediatike, nga ZPS-ja më

9 shtator janë futur në qeset e provave?
Pë. Po.
Py. A mund të verifikoni që këto prova lidheshin dhe janë dorëzuar si rezultat të Njësisë së Menaxhimit të Provave të ZPS-së?
Pë. Po.
Py. A keni verifikuar mbi bazën e të dhënave të ZPS-së që dokumentet janë marrë më datën 9 shtator nga media dhe ata janë shënuar me një numër ERN?
Pë. Po.
Py. Dokumentet që keni rishikuar që juve ju drejtuat si Paketa numër 4, a përfaqësonin të njëjtin numër ERN-je siç dhe dokumentet, të cilët juve i keni parashtruar si prova materiale pas dorëzimit të këtyre dokumenteve nga media?
Pë. Po.
Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj tani t'i tregoj dëshmitarit dokumentin me numër ERN 08120 deri në 08128RED [sipas përkthimit]. Është dokumenti që keni përpara në ndarjen 27 bis të dosjes që keni përpara.
Py. A e njihni këtë dokument?

Z. REES: [Përkthim] Mbase mund ta japë edhe njëherë numrin e referencës znj. Prokurore?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] 082010 deri në 082011RED. Po, 1-3. Më falni. E përsëris edhe njëherë 082010 deri në 082013RED.

Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kemi një kundërshtim të ngjashëm edhe me këtë provë. Ju lutemi Trupit Gjykues që të mbajë shënim Trupin Gjykues këtë kundërshtim më falni edhe ta trajtojë në momentin e duhur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, ju kuptuam.

Z. Cadman keni gjë?

Z. CADMAN: [Përkthim] Thjesht për t'ju rikujtuar i nderuar Gjykatës se mikrofoni nuk e kishit ndezur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë mesa duket ma kujtojnë këtë gjë. Kundërshtimi është mbajtur shënim edhe për të do të merret vendim.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Hetuese, e njihni këtë dokument?

Pë. Po.

Py. A e keni parë më përpara këtë Notë Zyrtare?

Pë. Po.

Py. A mund të na thoni nëse kjo Notë Zyrtare është dorëzuar në databazën e provave të ZPS-së?

Pë. Po, është dorëzuar.

Py. Nga e dini këtë?

Pë. E shoh sepse ka numrin ERN në qoshen e djathtë sipër.

Py. Ju lutem vini re emrin e autorit të kësaj Note Zyrtare në pjesën e sipërme të faqes, të dy faqeve, d.m.th. edhe në faqen 082013 edhe në 082010, po mos e thoni emrin se jemi në seancë

të hapur. E njihni këtë person?
Pë. Po.
Py. A mund të na thoni se çfarë funksioni, çfarë titulli profesional ka?
Pë. Është hetues.
Py. A është personel i ZPS-së?
Pë. Po.
Py. A e dini nëse ky person ka qenë personel i ZPS-së më 17 shtator 2020.
Pë. Po.
Py. Dhe si personel i ZPS-së që jeni ju vetë, a keni pasur mundësi që të flisni ndonjëherë me autorin e kësaj Note Zyrtare lidhur me aktivitetet zyrtare që ka kryer ai më datë 17 shtator 2020?
Pë. Po, kam biseduar me të.
Py. Dhe a keni marrë vesh çfarë aktivitetesh ka kryer më datë 17 shtator 2020?
Pë. Po.
Py. Dhe çfarë informacioni keni mësuar?
Pë. Ai ka bërë bisedë, më falni, ne kemi bërë biseda lidhur me këtë Notë Zyrtare dhe për përmbajtjen e kësaj Note Zyrtare, dhe mësova, mora vesh hollësitë se si ai sekuestroi atë që unë e quaj Paketa 2 nga Organizata e Veteranëve të Luftës, se rrimë në të njëjtën zyrë nëse mund ta them edhe këtë.
Py. Ju lutem shihni paragrafin 18 të kësaj Note Zyrtare. Në

bazë të Notës Zyrtare, a kuptohet se kush nga Organizata e Veteranëve të Luftës e ka nënshkruar formularin e dorëzimit të dokumenteve që janë sekuestruar nga ZPS-ja më datë 17 shtator 2020?
Pë. Në bazë të këtij paragrafi këtu thuhet se z. Hysni Gucati ka nënshkruar në emër të Organizatës së Veteranëve të Luftës.
Py. Faleminderit. Dëshiroj tani që t'i tregoj dokumentin me numër ERN 079500 të këtij paragrafi, në ndarjen 28 të dosjes që keni përpara.
ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është pranuar tashmë në prova, me numër prove P00055.
Py. Hetuese, a e keni parë më përpara këtë dokument?
Pë. Po.
Py. A mund të thoni se ç'është ky dokument?
Pë. Është procesverbali i dorëzimit që është përpiluar për Paketën 2 të Organizatës së Veteranëve të Luftës, ia ka dorëzuar kolegut tim.
Py. A mund të na thoni datën e këtij dokumenti?
Pë. Data është 17 shtator 2020.
Py. Dhe kush përcaktohet këtu si dorëzuesi i dokumenteve për të cilat bëhet fjalë këtu?
Pë. Këtu shkruhet "Z. Hysni Gucati, Kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës."
Py. Po të shihni emrin e marrësit pa ia thënë emrin, a e dini se kush është ky person?

Pë. Është i njëjti hetues që ka përpiluar Notën Zyrtare. Sapo folëm për të.

Py. Po të shihni se çfarë shkruhet aty tek pjesa, përmbajtja e këtyre dokumenteve, çfarë janë këto dokumente?

Pë. Thuhet këtu, "Dokumentet që Organizata e Veteranëve të Luftës" ia ka sjellë "një burrë i panjohur më datë 16 shtator 2020".

Py. Faleminderit. Një moment ju lutem.

A ju kujtohet numri i ERN-së, numri ERN i dokumenteve të Paketës 2 që keni parë?

Pë. Nuk e mbaj mend përmendësh. Do të doja ta shihja deklaratën time, nëse më lejohet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Mund ta lexoj?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, ju lutem.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Është regjistruar 079512 deri në 080448.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. A mund të na thoni nëse dokumenti i dorëzimit që sapo jua treguam bënte apo jo pjesë në dokumentet që keni shqyrtuar të cilat ju i quani si Paketa 2?

Pë. Po e konfirmoj.

Py. Vë re se numri ERN të cilin ju përmendni si Paketa 2 fillon me numrin 079512 dhe dokumenti i dorëzimit që ne sapo pamë fillon me 079500. A mund të na thoni nëse ky dokument

dorëzimi bënte apo jo pjesë në dokumentet që ju keni shqyrtuar dhe i keni përfshirë në prova, i keni dorëzuar në prova?

Pë. Po, mund ta shpjegoj. Dokumenti i dorëzimit bënte pjesë, ishte faqja e parë. Pas kësaj vinte urdhri i Gjykatës dhe pastaj dokumenti i parë i Paketës, prandaj dhe është ky kapërcim në numra.

Py. Pra, këto 11 faqe nga 079500 në 079512 është kopja e urdhrit të Gjykatës që përmendet në dokumentin e dorëzimit dhe në Notën Zyrtare?

Pë. Po, e saktë.

Py. Dhe dokumenti i dorëzimit është ballina, fleta ballinë e dokumenteve që ju keni parë?

Pë. Po, e saktë.

Py. Faleminderit. Mund të përshkruani shkurtimisht përgjithësisht se çfarë kategori dokumentesh janë të përfshira në Paketën 2?

Pë. Paketa 2 përbëhej nga dy kategori në fakt me përjashtim të pak dokumenteve, në përgjithësi ishin vendime gjykatash në çështje të ndryshme gjyqësore. Ka edhe disa dokumente që bënin pjesë edhe në Paketën 1, më duket nja pesë a gjashtë.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit. Dua që dëshmitares t’i tregojmë dokumentin me numër ERN 079512 deri në 080448RED që është e gjithë Paketa 2 në version të redaktuar, ku janë redaktuar vetë në faqet konfidenciale.

Py. Hetuese, ju e keni në një dosje më vete këtë ku përfshihet

vetëm Paketa numër 2. Është ndarja 29, po në fakt në vetvete është një dosje fizikisht më vete.

Pë. [Nuk ka përkthim].

Py. Hetuese, e di që është një Paketë shumë voluminoze, por po të shikoni nga ERN-ja, nga numri ERN thjesht duke e parë, a mund të thoni, a mund të konfirmoni që këto janë dokumentet që ju keni shqyrtuar si pjesë e Paketës 2?

Pë. E nderuar, të nderuar Gjykatës a mundet të shoh edhe njëherë deklaratën për të verifikuar vargun e numrave ERN?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit. Mund të konfirmoj se vargu i numrave ERN përputhet me vargun e numrave ERN, të cilin unë e lexova përpara.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Hetuese, nëse mund të shihni në dosjen që keni përpara, faqet me numër ERN-je 080126 deri në 080131. Faqet që keni përpara janë të redaktuara. Pyetja që kam është kjo, a e keni parë versionin e paredaktuar të këtyre faqeve?

Pë. Unë kam parë faqet që unë i kam përshkruar në deklaratën time, ato pesë a gjashtë faqe, se unë në fakt, këtu nuk i shikoj faqet, kështu që do të mbështetesha te deklarata dhe tek versioni që kam parë.

Py. Do ta shohim pas pak deklaratën tuaj. Por a mund tu thoni Gjykatësve se në përgjithësi çfarë përmbanin këto gjashtë faqe që janë redaktuar prej këtu?

Pë. Më kujtohet që ishin kërkesa koordinimi, nja dy dokumente në gjuhën serbe.

Py. Faleminderit. Dëshiroj që dëshmitares t'i tregojmë deklaratën me numër ERN 084015 deri në 084026 të datës 29 tetor 2020, që është në ndarjen 1. Ju lutem të shihni paragrafët në faqen 08018 deri në 08 më falni, 084019 [sipas përkthimit]. Më saktë janë paragrafët nga 23 deri në 27.

Py. Hetuese, a keni përshkruar në këta paragrafë ju gjashtë faqet e Paketës 2 që përmbajnë material konfidencial?

Pë. Po.

[Prokurorët e Specializuar këshillohen midis tyre]

Z. REES: [Përkthim] A mund të bëjmë një pauzë të shkurtër në mënyrë që ekrani i provave t'i mbulojë të gjithë paragrafët? Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Numri ERN nuk është i saktë. Është 08418 [sipas përkthimit]. Pra, është në vargun 084015 deri në 084026.

Z. Sekretar, nuk është në këtë dokument, është në një varg tjetër ERN-ja. Edhe njëherë është dokumenti me numër ERN-je 084015 deri në 084026, P86 MFI. Faleminderit.

Ju lutem të vendosni në ekran faqen me numër katër dhe pesë të këtij dokumenti, me numër ERN-je 084018 deri në 084019.

Py. Hetuese, duke parë paragrafët 23 deri në 26 [sipas

përkthimit] të deklaratës suaj, a mund të thoni se çfarë keni përshkruar në këta paragrafë?
Pë. Këta paragrafë të veçantë flasin për gjashtë dokumentet, të cilat unë i përmenda, të cilët ishin pra në Paketën 2, krahas vendimeve gjyqësore.
Py. Faleminderit. A verifikuat ju nëse këto gjashtë dokumente që përshkruani në këtë paragraf kanë qenë të përfshirë edhe në Paketën 1?
Pë. Po.
Py. A ishin të përfshira?
Pë. Po, ishin.
Py. A verifikuat nëse ndonjë prej gjashtë faqeve që përshkruhen në këta paragrafë përfshinin emra dëshmitarësh faktikë apo të mundshëm të TFHS-së apo ZPS-së?
Pë. Po.
Py. Dhe çfarë rezultati pati ky verifikim?
Pë. Ishte rezultat pozitiv, d.m.th. që kishin emra të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.
Py. Dhe ju i përshkruani hollësitë e këtyre dokumenteve në këta paragrafë?
Pë. Po.
Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj tani që t'i tregojmë dëshmitares provën me numër P0002-ET që është transkript.
Py. Është ndarja 30 në dokumentet që keni përpara.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kërkoj që të kalojmë shkurtimisht në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për arsye konfidencialiteti do të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara se të kalojmë në temën tjetër, dëshiroj që të kërkoj pranim të provave të dokumenteve me numër ERN-je 082010-082013RED.

Apo mund të kthehemi në seancë publike për këtë, kërkoj ndjesë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa për t'u sqaruar, ju keni kërkuar që të paraqisni në prova disa dokumente që nuk i ka përgatitur dëshmitarja.

Dua që të sqaroj këtë, doni që të gjitha Notat të pranohen apo vetëm ato që i keni treguar dëshmitares sepse ju keni parë vetëm disa paragrafë të kufizuar të këtyre Notave Zyrtare. Prandaj dua të kuptoj kur ju kërkoni që të pranohen në prova, të kërkoni që të pranohen në tërësi këto dokumente apo vetëm ato paragrafë që janë parë?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne kërkojmë që ato të pranohen në tërësi në prova, për aq sa ato vërtetohen si origjinale nga dëshmitarja. Pra vërtetohen si një dokumentacion zyrtar i ZPS-së.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni

përfunduar?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo. Duam që të kalojmë në seancë publike për këtë qëllim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Mund të kalojmë në seancë publike.

Z. CADMAN: [Përkthim] Thjesht për të vërejtur se kundërshtimet tona qëndrojnë dhe duhen mbajtur shënim.

Z. REES: [Përkthim] Bëjmë të njëjtin parashtrim edhe ne në emër të z. Gucati, i nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të mbuloj nga i njëjti vendim procedural, i cili është shtyrë në kohë, por dokumenteve do t'u caktohet një numër MFI, dhe do ta trajtojmë më pas.

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike i nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të përsëris të njëjtën kërkesë në seancë të hapur. Kërkoj që të pranohen në prova dokumenti me numër ERN-je 082010 deri në 082013RED dhe e gjithë ERN-ja e Paketës 2 që është 079512 deri në 080448RED.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni përfunduar kërkesën?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Pjesë e të njëjtit vendim procedural do ta shtyjmë këtë për pranimin.

Sekretarit të Gjykatës i lutem që t'i shënojë për identifikim me numër P-je.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dokumenti i parë me numër ERN-je 082010 deri në 082013RED merr numrin P103 MFI, ndërsa vargu tjetër i ERN-së prej 079512 deri në 080448RED merr numrin P104 MFI.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Py. Hetuese, i keni parë dokumentet që përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës ia dorëzuan përfaqësuesve të ZPS-së më datë 22 shtator 2020?

Pë. Po.

Py. Dhe për ta thjeshtuar referencën e këtyre dokumenteve siç kemi vepruar gjatë gjithë këtij procesi, do ta quaj këtë dokumentacion si Paketa 3.

A mund të më thoni nëse, sesi ju konstatuat që këto dokumente, pra dokumentet që ju patë kanë qenë ato, të cilat janë marrë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së më datën 22 shtator 2020?

Pë. Është i njëjti proces. Kam parë Notat Zyrtare të

sekuestrimit të tyre, procesverbalin e dorëzimit. Krahas kësaj ajo që është ndryshe në këtë rast është edhe një prej tyre të cilën unë vetë e kam transportuar në ZPS në një qese të vulosur provash dhe e hapa qesen e dytë të provave kur iu transportuan ZPS-së.

Py. Pra, a mund të verifikoni në bazë të dokumentacionit zyrtar të ZPS-së, që këto dokumente janë marrë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së më datë 22 shtator 2020 dhe që këto janë futur në qese provash?

Pë. Po, e konfirmoj.

Py. Dhe ju keni transportuar njërën prej qeseve të provave në Hagë, kështu?

Pë. Po, e saktë.

Py. Dhe ju e hapët vetë këtë qese provash?

Pë. Po.

Py. Dhe ju i keni dorëzuar këto dokumente në prova?

Pë. Po.

Py. Dhe ju morët numër ERN-je pas dorëzimit të këtyre dokumenteve në prova?

Pë. Po.

Py. Dhe numri ERN i dokumenteve që ju patë përkon me numrin ERN që keni marrë pas dorëzimit të dokumenteve që përmbante qesja e provave në databazën e provave të ZPS-së.

Pë. Po, e saktë.

Py. A e hapët edhe qesen e dytë të provave që përmbante

dokumentet që janë marrë nga Organizata e Veteranëve të Luftës më datë 22 shtator 2020?

Pë. Po.

Py. Dhe a i keni dorëzuar vetë ju në prova këto dokumente?

Pë. Po.

Py. A keni marrë numër ERN-je pas dorëzimit të këtij dokumenti në prova?

Pë. Po.

Py. Dhe numri ERN i dokumenteve që ju patë, a përkon me numrin ERN që keni marrë pasi i dorëzuat këto dokumente të qeses së dytë të provave në prova?

Pë. Po, e saktë.

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani dëshiroj që dëshmitares t'i tregoj dokumentin me numër ERN 082014 deri në 082016, që është ndarja 39 në dosjen që keni përpara.

Py. Hetuese, a keni parë këtë Notë Zyrtare më përpara?

Pë. Po.

Py. A mund të thoni nëse kjo Notë Zyrtare është dorëzuar në databazën e provave të ZPS-së?

Pë. Po, e konfirmoj.

Py. Mbi ç'bazë e thoni këtë?

Pë. Ka numër ERN-je. Pra përmban një numër ERN.

Py. Në rregull. A e dini se kush është autori i kësaj Note Zyrtare pa ia përmendur emrin?

Pë. Po, e njoh. Është hetues i ZPS-së.
Py. Është i njëjti hetues i ZPS-së që ka qenë autor i Notës Zyrtare për sekuestrimin e datës 17 shtator?
Pë. Po.
Py. Si personel i ZPS-së, keni pasur rastin që të bisedoni me autorin e kësaj Note Zyrtare lidhur me aktivitetet zyrtare që janë kryer më datë 22 shtator 2020?
Pë. Po.

Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem që të mbani shënim kundërshtimin tonë lidhur me përgjigjen që i kërkohet dëshmitares lidhur me këtë Notë Zyrtare.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. A përputhej informacioni që morët ju nga autori i kësaj Note Zyrtare me informacionin që përfshihej në këtë Notë Zyrtare?
Pë. Po.
Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj tani që t'i tregojmë dëshmitares dokumentin me numër prove P0058 [sipas përkthimit] që është dokumenti me numër ERN SPOE00220915 në ndarjen 41 të dosjes që keni përpara.

A e keni parë këtë dokument më përpara?

Pë. Po.
Py. A mund të na thoni se për çfarë bën fjalë ky dokument?
Pë. Ky dokument është procesverbal dorëzimi i urdhrit të ZPS-

së për të sekuestruar Paketën numër 3.

Py. A mund të shihni datën e këtij dorëzimi dhe të thoni se cila është data e regjistruar?

Pë. Data e regjistruar është data 22 shtator 2020.

Py. Pa përmendur a emrin, a mund të thoni se kush është dorëzuesi sipas dokumentit, pra si është shënuar këtu në këtë urdhër-përgjigje. Është i njëjti koleg, hetues i ZPS-së, i cili ka hartuar Notën Zyrtare, siç e kam parë më përpara.

Py. Faleminderit. Ju lutem shihni rubrikën apo rreshtin ku thuhet "Marrësi".

A e kuptoni se emri i kujt është aty?

Pë. Shkrimi më tregon se është emri i z. Nasim Haradinaj.

Py. Faleminderit.

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua që të kërkoj pranimin në këtë fazë të dokumentit që iu tregua dëshmitares pak përpara me numër ERN 082014 deri në 082016.

Kam dhe dy pyetje të tjera.

Py. Kur e keni parë për herë të parë Njoftimin e Dorëzimit?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe kjo do të lihet për më vonë dhe do t'i jepet një numër i ri.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Numri do të jetë 080214 dhe do të jepet numri P105 MFI.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Prapë jemi te tema e pranimit të dorëzimit.

Py. Kur e keni parë këtë njoftimin, pra pranimin e dorëzimit?

Pë. E pashë për herë të parë ose në qesen e provave, qesen e parë apo qesen e dytë të Paketës 2 apo 3.

Py. Të shohim tani dokumentin me numër ERN – është prova -- po të shohim provën materiale me numrin P0054 [sipas përkthimit], hetuese është dokumenti në nënndarjen 40 të dosjes që keni përpara.

A mund të më thoni se cili është ky dokument?

Pë. Është urdhri i Prokurorisë që e përmenda më herët, i cili m'u dha, m'u dorëzua dhe dokumentacioni i dorëzimit.

Py. Kur e keni parë për herë të parë këtë dokument?

Pë. Po jap të njëjtën përgjigje. Nuk jam e sigurt nëse e kam parë te Paketa 1, më falni, ke Pjesa 3 e Paketës së Parë apo ke Paketa e Tretë.

Py. Çfarë keni parasysh kur thua "Grupi 1 i Paketës 1" apo "Grupi 2 i Paketës 3"?

Pë. Kur ZPS-ja shkoi ke OVL UÇK-ja dhe i bazohem notës dhe hetuesit, pasi fola me hetuesin që ke parë – pra OVL UÇK-ja dorëzoi katër grupe dokumentesh, katër pjesë. E morën të katërtën dhe kur e panë e kuptuan se ka dy kopje të të njëjtit dokument. Gjatë shqyrtimit kur një koleg po shikonte, po bënte një shqyrtim tjetër, i futën në dy qese provash dhe për dokumentacionin e duhur, unë shënova grupi 1 i Paketës 3,

grupi 2 i Paketës 3 në vend që të quaja një paketë të një grupi.

Py. A mund të më përshkruani se çfarë dokumentesh përmbante Paketa 3, grupi 1 dhe Paketa 3, grupi 2?

Pë. Është një përshkrim i ZPS-së për provat e mbledhura në qendrat e ndalimit.

Py. A mbani mend sesa faqe përmbante grupi 1 dhe grupi 2 përkatësisht secili?

Pë. Njëri përmbante 244, tjetri 245 faqe.

Py. Në ç'gjuhë ishin dokumentet që ju përmendët si Paketa 3?

Pë. Në gjuhën angleze.

Py. A e mbani mend me ç'numër ERN ishin këto dokumente përkatësisht, pra të dy kopjeve të përshkrimit që përmendët të cilët u morën në OVL UÇK në 22 shtator 2020?

Pë. Të njëjtë si më parë. Më lejoni që t'i shikoj dokumentet se se mbaj mend përmendsh numrin.

Z. CADMAN: [Përkthim] Për të përsëritur kundërshtimin tonë, Dëshmitarja nuk ka qenë e pranishme. Po bën komente për gjëra që nuk i di. Kështu që ne e përsërisim kundërshtimin tonë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [E padëgjueshme].

DËSHMITARJA: [Përkthim] Pra një grup kishte 244 dokumente, është regjistruar si SPOE00220920-SPOE00221163. Grupi përmbante 245 faqe, është regjistruar si SPOE00222289-SPOE00222533.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Py. Faleminderit.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

Dëshiroj tani t'i tregoj Dëshmitares dokumentin me numër ERN SPOE00220920 deri në SPOE00220928.

Është nënndarja 42 në grupin e dokumenteve që keni në dosje.

Py. Hetuese, a mund t'i thoni Gjykatës se përse bëjnë fjalë këto faqe? Ç'janë këto faqe?

Pë. Këto faqe, bëhet fjalë të jem e saktë për faqen e parë, faqe 3 deri në 10 të Paketës 3.

Py. Si mund ta thoni - ku bazoheni që e thoni këtë? Në çfarë informacion bazoheni?

Pë. Unë e shqyrtova Paketën 3.

Py. Po numri ERN që është stampuar në këto faqe që ju patë cili është?

Pë. Ja një moment. Po.

Py. Të lutem shiko faqen me numër ERN SPOE00220922.

A të kujtohet në kishte ndonjë shënim konfidencial në këto faqe?

Pë. Kjo faqe dhe pjesa më e madhe e faqeve janë të shënuara me fjalën "Konfidenciale" në krahun e djathtë sipër dhe në anën e majtë poshtë, po ashtu "Konfidenciale".

Py. Faleminderit. Kjo faqe përfshin ndonjë stemë, ndonjë emblemë të Zyrës së Prokurorisë?

Pë. Po.

Py. Sapo përmendët se shumica e faqeve të Paketës 3 përfshinin këtë shënimin “Konfidencial”. A mund të na jepni më shumë hollësi lidhur me këtë?

Pë. Mund të them vetëm se, jo çdo faqe kishte të njëjtën – ishte kopjuar me të njëjtën cilësi. Por shumica e tyre përmbanin n.q.s. do ta quajmë një titull këtë në krahun e djathtë edhe poshtë në anën e majtë këtë fjalë, "Zyra e Prokurorisë" dhe atë emblemën. Diçka prej tyre kur e kanë kopjuar ka mbetur jashtë dhe dukeshin vetëm pjesë të ndryshme të saj.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua t’i kthehemi deklaratës së Hetueses me numër 095533 deri në 095602, nënndarja 6 në dosjen tuaj.

Py. Po të shihni faqen 095535 në veçanti paragrafin 8(iii), këtu shkruani se – një moment:

“Numri më i madh i faqeve kishin këto shënimet lart e poshtë, pra kishin “Zyra e Prokurorisë” dhe fjalët “Konfidenciale” dhe në fund përmbahej në qoshen e majtë përbëhej po ashtu “Konfidenciale” dhe dukej sikur fillimi dhe fundi ishin prerë, por në secilën nga faqet fjala “Konfidenciale” lexohej mirë, një herë të paktën, o në fillim në krye të faqes o në fund, me përjashtim të pesë faqeve ku nuk kishte as në fillim as në fund, ishte e prerë fjala “Konfidenciale”, një herë duket, një herë ose në krye ose në

fund të faqes.

Py. Ky informacion a është i saktë?

Pë. Po.

Py. E keni parë se cila nga faqet e Paketës 3 kur keni bërë një deklaratë të tillë?

Pë. Po.

Py. Po të shikojmë paragrafin 9(iii) në faqen 095536 i njëjti informacion është si në rastin e Paketës 3. A mund të na thoni nëse është i saktë një informacion i tillë?

Pë. Po, mund ta konfirmoj.

Py. Dua që tani të shohim Shtojcën 5 të kësaj deklarate që janë faqet 095600 deri në 095602.

A mund të na thoni se çfarë keni përfshirë në këtë shtojcë?

Pë. Kjo shtojcë përfshin mostra, kampione të asaj që unë pashë në secilën faqe. Tek A-ja kam dhënë mostra, kampionë të asaj që përmbanin në fillim dhe në fund të faqes, ato që unë te B-a kam përfshirë ato që ishin të pjesshme, që dukeshin pjesërisht në krye dhe në fund të faqes.

Py. Faleminderit. Kam edhe disa pyetje për përmbajtjen e faqeve të Paketës 3, të cilat ua treguam.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I lutem Sekretarit t’i paraqesë edhe njëherë në ekran dokumentet me numër ERN SPOE00220920 deri në SPOE00220928.

Py. Është prapë nënndarja 2, më falni 42.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do t'ju kërkoja të nderuar Gjykatës të kalonim shkurtimisht në seancë private për pyetjen tjetër.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seancë private. Për qëllime kofidencialiteti do të kalojmë në seancë private.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: Të nderuar Gjykatës jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni znj. Prokurore.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kërkoj leje në këtë moment që dokumentet me numër ERN SPOE0022920 deri në SPOE0022928 si pjesë e dokumenteve që janë marrë më datë 22 shtator 2020 në Organizatën e Veteranëve të Luftës të UÇK-së siç janë vërtetuar për sa i takon origjinalitetit nga Dëshmitarja janë përkatëse dhe provuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta shtyjmë në kohë vendimin për pranueshmërinë e tyre, pranimin e tyre.

Sekretarit i lutem që të caktojë një numër P-je.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo merr numrin P106 MFI.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke patur parasysh orën, unë nuk do filloj me faqet e tjera të Paketës 3, të cilat ne do kërkojmë që të pranohen në prova. Presim udhëzim nga Trupi Gjykues nëse Trupi Gjykues kërkon nëse Dëshmitarit t'i tregohet çdo faqe për të bërë kërkesën apo nëse kjo kërkesë mund të bëhet në bazë të numrave ERN të këtyre faqeve për të cilat Dëshmitarja ka dëshmuar se bëjnë pjesë në vargun ERN të Paketës 3. Thjesht për ta ditur këtë nëse do të fillojmë me secilin dokument nesër apo mund të bëjmë kërkesë të përgjithshme për këto faqe.

[Trupi Gjykues këshillohet midis tyre]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara marrjes së vendimit, ka Mbrojtja ndonjë qëndrim për të mbajtur lidhur me kërkesën që ua ka bërë znj. Prokurore?

Dëshironi që të ndjekim qasjen e përgjithshme duke përdorur numrat ERN apo dëshironi që të ndjekim qasjen faqe pas faqe.

Nuk ka mikrofon Avokati.

Z. REES: [Përkthim] E ka në dorë vetë ZPS-ja si i paraqesin provat e tyre nëse Dëshmitarja mund të provojë, atëherë asaj duhet t'i tregohen të gjitha faqet, po i takon ZPS-së.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju kuptova qartë.

Z. REES: [Përkthim] Po nuk jam i sigurt nëse e kam

kuptuar mirë kërkesën e znj. Bolici.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Bolici?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ka një sërë faqesh në Paketën 3, të cilat janë përfshirë në listën e provave materiale për t'ju treguar kësaj Dëshmitareje dhe për të cilat do të kërkohet që të pranohen në prova përmes kësaj Dëshmitareje. Unë këtë punë mund ta bëj duke ia treguar faqe për faqe dhe të kërkoj konfirmim në lidhje me secilën faqe, ose nga ana tjetër mund të bëj një kërkesë të përgjithshme, që duke qenë se ky dokumentacion bën pjesë në vargun ERN, Dëshmitarja mund të vërtetojë vetë për të gjithë këtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman, juve keni qëndrim për të mbajtur?

[Avokatët e Specializuar këshillohe midis tyre]

Z. CADMAN: [Përkthim] Qëndrimi ynë i nderuar Gjykatës lidhet me atë që ju të nderuar Gjykatës thatë më përpara, pra kundërshtimi. Pra më saktë qëndrimi ynë është që nëse ato kërkojnë që i gjithë dokumenti të pranohet atëherë duhet ta bëjmë faqe për faqe.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë mesa duket do jetë faqe për faqe.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë në

rregull. Për sot përfunduam.

Ju lutem shoqëroheni Dëshmitaren që të dalë nga salla.

DËSHMITARJA: Faleminderit.

[Dëshmitarja përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman, keni fjalën.

Z. CADMAN: [Përkthim] Përpara se ta mbyllni seancën, z. Haradinaj dëshiron që unë të ritheksoj faktin se ai ka shqetësime reale – që është ngritur përpara nga Mbrojtja – ai më kërkoi që të ritheksoj se Dëshmitarja që është dëgjuar sot po dëshmon për çështje të cilat qëndrojnë jashtë njohurive të saj. Ajo nuk është përfshirë në asnjë prej ngjarjeve për të cilat ka dhënë dëshmi sot. Thjesht desha që ta ritheksoj këtë pikë siç më është bërë e ditur nga z. Haradinaj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, u mbajt shënim. Ajo sot ka dëshmuar për procedurat normale të punës në zyrën e saj, për të cilën ajo ka dijeni dhe për këtë arsye ne e kemi dëgjuar dëshminë e saj dhe do të vijojmë ta dëgjojmë.

Do të rimblidhemi nesër në orën 9.30 sipas urdhrit të lëshuar më parë. Do të shihemi atëherë.

Këtu e ndërpresim seancën.

--- Seanca mbyllet në orën 16.00 pasdite.